QEVERIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL

RAPORT I FUNKSIONIMIT TË KOMUNAVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

JANAR-DHJETOR 2008

Mars, 2009

- **Raporti i kompletuar është hartuar nën mbikëqyrjen e Rozafa Ukimeraj, Drejtoreshë e Departamentit për Vetëqeverisje Lokale**

- **Të dhënat nga Komunat u mblodhën nga zyrtarët e Divizionit të Monitorimit të Komunave dhe Divizioni për të Drejtat e Njeriut, Departamenti i Vetëqeverisjes Lokale**

- **Analiza e raportit është përgatitur nga Divizioni për Planifikim dhe Analiza, Divizioni për Vlerësim të performancës së Komunave dhe asistenca teknike e CBF/UNDP**

- **Pjesa e legjislacionit është përgatitur nën përkujdesjen e Agron Maxhuni, Drejtor i Departamentit Ligjor**

- **Pjesa financiare e raportit është përgatitur nën përkujdesjen e Besim Kamberaj, Drejtor i Departamentit për reformë dhe integrime Evropiane**

- **Për saktësinë e të dhënave të paraqitura në raport janë përgjegjëse Komunat e Republikës së Kosovës**

- **E Drejta autoriale e këtij raporti in takon Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal**

PËRMBAJTJA:

Fjala e Ministrit të Administrimit të Pushtetit Lokal

Përmbledhje ekzekutive

Hyrje

Qëllimi i hartimit të raportit

Struktura e raportit

Metodologjia e punës

PJESA E PARË:

FUNKSIONIMI I KUVENDEVE KOMUNALE

PJESA E DYTË

EFIKASITETI DHE AZHURITETI I ORGANEVE TË ADMINISTRATËS

- Komuna e Prishtinës
- Komuna e Podujevës
- Komuna e Fushë Kosovës
- Komuna e Obiliqit
- Komuna e Gllogocit
- Komuna e Lipjanit
- Komuna e Shtimes
- Komuna e Kamenicës
- Komuna e Novobërdës
- Komuna e Vitisë
- Komuna e Ferizajt
- Komuna e Hanit të Elezit
- Komuna e Kaçanikut
- Komuna e Mitrovicës
- Komuna e Vushtrrisë
- Komuna e Skenderajt
- Komuna e Prizrenit
- Komuna e Dragashit
- Komuna e Malishevës
- Komuna e Suharekës
- Komuna e Rahovecit
- Komuna e Mamushës

- Komuna e Pejës
- Komuna e Gjakovës
- Komuna e Deçanit
- Komuna e Istogut
- Komuna e Klinës
- Komuna e Junikut
- Komuna e Gjilanit

PJESA E TRETË

PROMOVIMI I TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE FUNSKIZONALIZIMI I NJËSITEVE PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË KOMUNA

Respektimi i të drejtave të njeriut në nivelin Komunal me vështrim të posaçëm në funksionalizimin e Njësiteve per të Drejtat e Njeriut në Komuna

PJESA E KATËRT

FINANCAT LOKALE

REKOMANDIME

Fjala e Ministrit të Administrimit të Pushtetit Lokal

Forcimi i strukturave të qeverisjes lokale me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më afër qytetarëve paraqet objektivin kryesorë të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

Shteti i Kosovës gjendet në një fazë të tranzicionit politik, ekonomik dhe social, ndërsa në këtë proces Komunat kanë rolin kryesorë në ndërtimin e një qeverisje efektive, ushtrim i pushtetit me përgjegjësi, krijimin e administratës efikase dhe jo burokratike, promovim të të drejtave të njeriut, transparencë të punës së organeve të Komunave dhe ofrim të shërbimeve sa më afër qytetarëve, sipas standardeve Evropiane.

Në lidhje me këtë, me qëllim të sigurimit të qeverisjes së mirë në nivelin komunal, krijimin e hapësirave për pjesëmarrje demokratike dhe fuqizim të rolit të qytetarëve në vendimmarrje dhe në mënyrë që të sigurohet ushtrimi i kompetencave sipas ligjit, MAPL, duke u bazuar në përgjegjësitë që ka, bën mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë së aktiviteteve dhe vendimeve të komunave dhe harton raportet periodike.

Raporti konkret, ofron një pasqyrë të aktiviteteve të Komunave të Republikës së Kosovës, duke përfshirë periudhën janar- dhjetor 2008. Raporti është rezultat i analizës së të dhënave që janë siguruar nga monitorimet e Komunave nga ekipet e monitorimit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal. Raporti pasqyron gjendjen reale të funksionimit dhe aktiviteteve të Komunave, duke vënë në dispozicion të qytetarëve, institucioneve qeveritare dhe institucioneve tjera që punojnë me komunat, një pasqyrë të qartë me të të gjitha çështjet që kanë të bëjnë edhe me ndryshimin e organizimit që doli si rezultat i hyrjes në fuqi të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Përmes kësaj fjale dua t'i inkurajoj Komunat që të vazhdojnë të ushtrojnë kompetencat e tyre me përgjegjësi për të përmbushur detyrimet ligjore, kushtetuese dhe programore përballë sfidës së reformimit të pushtetit lokal. Njëkohësisht, i falënderoj të gjithë ata që dhanë kontributin e tyre, për të finalizuar këtë raport.

Sinqerisht,

Sadri Ferati
Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal

Përmbledhje ekzekutive

Kjo përmbledhje është përgatitur me qëllim që të pasqyrojë në mënyrë sa më koncize dhe në pika të shkurtra raportin e funksionimit të komunave në Republikën e Kosovës, për periudhën Janar-Dhjetor 2008, për të gjithë ata që nuk kanë kohë të shfletojnë raportin gjithpërfshirës.

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës dhe hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës, u hodh edhe hapi i dytë drejt reformës dhe avancimit të autonomisë së Komunave. Në qershor të vitit 2008, pasoi hyrja në fuqi e një numri të konsiderueshëm të Ligjeve, duke plotësuar kornizën ligjore të Kosovës. Mes tyre edhe Ligji për Vetëqeverisje Lokale, që përkufizon statusin ligjor të komunave, kompetencat dhe parimet e përgjithshme të financave komunale, organizimin dhe funksionimin e organeve komunale, marrëdhëniet brenda komunale dhe bashkëpunimin ndër komunal, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkufitar dhe marrëdhëniet ndërmjet komunave dhe pushtetit qendror.

Për këtë arsye, në raport pasqyrohen hollësisht dallimet mes Rregullores së vjetër dhe Ligjit të ri për Vetëqeverisje Lokale, si dhe përmbushja që i kanë bërë Komunat detyrimeve të reja në shumë fusha, si mbledhjet e Kuvendeve Komunale, zgjedhjet e kryesuesve te Kuvendit, zgjedhja e zëvendës kryesuesve nga minoritetet, funksionimi i komiteteve të komunave, peticionet drejtuar komunës, rregulloret për përdorimin e gjuhës e të tjera.

Në përgjithësi rezulton se shumica e komunave kanë përmbushur me sukses të gjitha detyrimet që rrjedhin nga LVL.

Funksionimi i administratës komunale dhe respektimi i të drejtave të njeriut në nivelin komunal janë dy pjesë integrale të raportit, që janë monitoruar nga MAPL. Sigurimi i një qeverisje të mirë në nivelin vendor, ofrimi i shërbimeve për qytetarët, mbrojtja e lirive dhe të drejtave të banorëve, krijimi i hapësirave për pjesëmarrje demokratike, respektimi i parimeve të sundimit të ligjit janë elementët thelbësorë që MAPL ka monitoruar dhe mbikëqyrur në vazhdimësi gjatë gjithë vitit.

Struktura e raportit

Raporti përmban përmbledhjen ekzekutive; hyrjen; metodologjinë e punës, si dhe të dhënat e analizuara, të ndara në katër pjesë:

- Pjesa e Parë: Funksionimi i Kuvendeve të Komunave;
- Pjesa e dytë: Funksionim i administratës komunale;
- Pjesa e tretë: Respektimi i të drejtave të njeriut në nivelin komunal; dhe
- Pjesa e katërt: Raporti i të hyrave dhe shpenzimeve të buxheteve Komunale.

FUNKSIONIMI I KUVENDEVE KOMUNALE

Lidhur me funksionimin e Kuvendeve të Komunave, raporti pasqyron aktivitetin e Kuvendeve të Komunave duke u fokusuar në seancat inauguruese të kuvendeve komunale, mbledhjet e Kuvendit Komunal, formimin e komiteteve të detyrueshme, formimin e komiteteve tjera, tubimet publike me qytetarët, kërkesat e qytetarëve për qasje në dokumentet zyrtare, rregulloret e miratuara gjatë kësaj kohe, përgatitja e statuteve komunale, struktura e drejtorive të Komunës, raportimin e Kryetarit të Komunës para Kuvendit, shqyrtimin e raportit financiar për vitin paraprak, dhe funksionimi i faqeve zyrtare të internetit të komunave, duke i pasqyruar ato në kontekstin e respektimit të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale.

Me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, komunat i ushtrojnë kompetencat e tyre sipas parimit të subsidiaritetit. Dallimi kryesor i LVL dhe Rregullores 2007/30 konsiston në ushtrimin e kompetencave të Komunës, ku përveç kompetencave vetanake dhe të deleguara, kanë edhe kategorinë e kompetencave të zgjeruara.

Mbledhjet e Kuvendeve të Komunave

Vlerësimi i gjendjes aktuale në Komuna - Në shumicën e Komunave, Kuvendet janë funksionale dhe e zhvillojnë veprimtarinë e tyre normalisht, përveç komunës së Novobërdës dhe Shtërpcës në të cilat kanë probleme në funksionalizimin e tyre, për arsye të njohura politike. Ndërsa, gati në të gjitha komunat materialet për pikat e rendit të ditës së mbledhjes iu dërgohen anëtarëve të Kuvendit sipas afateve të përcaktuara me ligj.

Konkretisht, gjatë vitit 2008 Kuvendet e Komunave, janë mbajtur mbledhje të rregullta si më poshtë: 14 mbledhje ka mbajtur Mitrovica, 12 mbledhje Deçani, Shtimja, Lipjani, Prizreni, Prishtina, Mamusha, 11 mbledhje ka mbajtur Malisheva, Suhareka, Gjilani, Rahoveci, Ferizaj, Peja, dhe Vushtria; 10 mbledhje Gjakova, Vitia, Kamenica, Fushë Kosova, Dragashi, Skënderaj, Hani Elezit, Gllogoci, Juniku, Istogu, Klina, Kaçaniku; 9 mbledhje Obiliqi; 8 mbledhje ka mbajtur Podujeva dhe Novobërda, kurse Kuvendi i Komunës së Shtërpcës ka mbajtur vetëm dy mbledhje.

Në Komunën e Novobërdës problemet janë paraqitur si pasojë e bojkotimit të punës së Kuvendit nga ana e anëtarëve të Kuvendit që i përkasin komunitetit serb. Pavarësisht kësaj, kuvendi i Komunës ka vazhduar mbajtjen e mbledhjeve edhe pa praninë e tyre.

Gjithashtu, edhe në Komunën e Shtërpcës, puna e Kuvendit Komunal dhe administratës komunale në përgjithësi është totalisht e bllokuar për shkak të bojkotit të punëtorëve serbë që punojnë në administratën komunale.

Për shkak të mungesës së të dhënave nga komunat e veriut, ku komuniteti serb është shumicë (komuna që nuk i janë përgjigjur pyetësorëve të hartuar nga MAPL), raporti nuk përmban aktivitetet e kuvendeve të këtyre komunave.

Konkluzione:

Shumica e Komunave janë brenda dinamikës së parashikuar për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendeve Komunale, në përputhje me nenin 43.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale.

Nga të gjitha Komunat e Republikës së Kosovës, vetëm 4 Komuna (Novobërdë, Obiliq, Podujevë dhe Shtërpcë) kanë mbajtur më pak mbledhje se sa është paraparë sipas legjislacionit në fuqi. 12 Komuna kanë mbajtur më shumë mbledhje gjatë gjashtëmujorit të dytë se sa gjatëgjashtë mujorit të parë të vitit 2008; 10 komuna i kanë mbajtur numrin e njejtë të mbledhjeve për të dy pjesët e vitit (gjashtëmujorat); ndërsa 8 komuna kanë mbajtur më pak mbledhje gjatë gjashtëmujorit të dytë se sa gjatë gjashtëmujorit të parë. Sipas evidentimit të gjendjes në Komuna është bërë e qartë se komunat gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2008 kanë mbajtur më shumë mbledhje se sa në gjashtëmujorin e parë të vitit 2008.

Zgjedhja e kryesuesve

Vlerësimi i gjendjes aktuale - Komunat e Gjilanit, Skënderajt, Rahovecit, Hanit të Elezit, Gllogocit, Junikut, Mamushës, Ferizajt, Istogut, Klinës, Kaçanikut, Pejës, Vushtrisë, Podujevës, Mitrovicës, Gjakovës, Suharekës, Malishevës, Lipjanit, Prizrenit, Shtimes, Vitisë, Kamenicës, Deçanit, Fushë Kosovës dhe Dragashit kanë zgjedhur kryesuesin e kuvendit komunal.
Ndërsa komunat e Obiliqit, Prishtinës, Novobërdës dhe Shtërpcës nuk kanë zgjedhur kryesuesin e Kuvendit Komunal.

Zgjedhja zëvendës kryesuesit për komunitete

Vlerësimi i gjendjes aktuale - Zëvendëskryesuesi i kuvendit të komunës për komunitete është zgjedhur në këto komuna: Gjakovë, Prizren, Fushë Kosovë, Dragash, Viti, Prishtinë, Ferizaj, Istog, Pejë, Gjilan, Skënderaj, Rahovecit, Obiliq, Hani i Elezit, Drenas, Juniku, Novobërdë, Mamushë, Klinë, Kaçanik. Ndonëse ka një përqindje të caktuar të minoriteteve, Kuvendet e Komunës së Lipjanit, Kamenicës dhe Shtërpcës nuk e kanë zgjedhur zv.kryesuesin e kuvendit të komunës për komunitete.
Komunat e Suharekës, Mitrovicës, Malishevës, Deçanit, Podujevës, Shtimes, dhe Vushtrisë nuk kanë zgjedhur Zv.kryesues për komunitete, për shkak se në këto komuna përqindja e komuniteteve nuk është deri në masën 10%, siç është parashikuar në LVL.

Konkluzione:
Në përgjithësi komunat kanë ndjekur procedurat sipas legjislacionit në fuqi në lidhje me zgjedhjen e Kryesuesve dhe zv. Kryesuesve të Komunave.

Funksionimi i komiteteve të Kuvendeve të Komunave

Vlerësimi i gjendjes aktuale në Komuna –

Komiteti për politikë dhe financa

Komiteti për politikë dhe financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave duke përfshirë dokumentet e planifikimin strategjik të komunës. Komitet janë mbledhur si më poshtë: 12 mbledhje Komuna e Shtimes, Pejës, Rahovecit, 11 mbledhje në Vushtri, Mitrovicë, Hani i Elezit, dhe Lipjani, 10 mbledhje janë mbajtur në Malishevë, Deçan, Klinë, Istog, Ferizaj, Gjilan, Skënderaj, Kamenicë, 9 mbledhje janë mbajtur në Suharekë, Junik, Prishtinë dhe Prizren; 8 mbledhje janë mbajtur në Podujevë, Mamushë, Obiliq, Gllogoc; 7 mbledhje në Dragash, Kaçanik dhe Gjakovë; 6 mbledhje janë mbajtur në Viti dhe Fushë Kosovë; 5 mbledhje në Novobërdë.
Në komunën e Shtërpcës ky komitet nuk është krijuar.

Komiteti për Komunitete

Komiteti për komunitete është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së veprimeve së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, për t'u siguruar se të drejtat e komuniteteve respektohen plotësisht.
Komitetet në komuna janë mbledhur si më poshtë: 11 mbledhje në Deçan, 10 mbledhje në Prizren; 9 mbledhje në Gjilan; 8 mbledhje në Gjakovë; 6 mbledhje në Vushtri dhe Suharekë, 5 mbledhje në Podujevë, Mamushë dhe Lipjan; 4 mbledhje në Dragash, Hani i Elezit, Istog dhe Shtime, 3 mbledhje në Malishevë, Skënderaj dhe Mitrovicë, 2 mbledhje në Fushë Kosovë, Ferizaj, Obiliq, 1 mbledhje në Kamenicë, Kaçanik, Rahovec dhe asnjë mbledhje në Viti.
Komunat e Prishtinës, Junikut, Novobërdës, Klinës dhe Pejës nuk kanë raportuar për numrin e mbledhjeve të komitetit për komunitete.
Ky komitet nuk është themeluar në Shtërpcë dhe Gllogoc.

Komitetet të tjera

Kuvendet e komunave, përveç komiteteve të detyrueshme për politikë e financa, si dhe për komunitete, themelojnë edhe komitete të tjera, në varësi të nevojave dhe vlerësimit që bëhet nga kuvendi komunal. Komitete të tjera, që janë ngritur pothuajse në të gjithë komunat, janë: Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, Komiteti për Shërbime Publike, Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Komiteti për Zhvillim Ekonomik, Komiteti për Barazi Gjinore etj.

Në vijim është paraqitur numri i komiteteve tjera që janë themeluar në komuna: Prizren (9), Prishtinë (8), Gjilan (7), Malishevë, Podujevë, Rahovec dhe Mitrovicë (6), Deçan dhe Kamenicë (5), Komitete tjera në Obiliq, Ferizaj, Klina, Kaçaniku (4), Lipjan, Skenderaj, Pejë (3), Mamushë (2) dhe në Suharekë, Fushë Kosovë dhe Shtime (1).

Ndërsa, në Komunën e Dragashit, Shtërpcës, Hanit të Elezit, Drenasit, Junikut, Novobërdës, Istogut dhe Vitisë nuk janë themeluar Komitete të tjera. Vushtria është në fazën e themelimit.

Konkluzione:

Komitetet e detyrueshme janë formuar gati në të gjitha komunat. Përjashtim bën komuna e Shtërpcës, e cila nuk e ka formuar komitetin për politikë dhe financa dhe Komitetin për komunitete. Gjithashtu, edhe komuna e Gllogocit nuk ka themeluar komitetin për komunitete. Aktivitet më dinamik ka pasur Komiteti për Politikë dhe Financa për dallim nga komitete tjerat.

Tubimet Publike

Vlerësimi i gjendjes aktuale në Komuna - Komuna e Prizrenit ka mbajtur 8 tubime publike, Prishtina 7 tubime, Kamenica 6 tubime, Hani Elezit dhe Klina kanë mbajtur nga 4 tubime, Podujeva, Rahoveci, Obiliqi dhe Gjakova nga 3 tubime, komuna e Vushtrrisë, Mitrovicës, Suhareka, Gjilanit, Skenderajt, Drenasit, Junikut, Ferizajt, Novobërdës, Istogut, Kaçanikut, Pejës, Malisheva, Lipjani, Shtime, Vitia, Deçani, Fushë Kosova dhe Dragashi kanë mbajtur nga dy tubime publike, kurse Shtërpca nuk ka mbajtur asnjë tubim publik.

Konkluzion:
Të gjitha Komunat, me përjashtim të Shtërpcës, kanë përmbushur detyrimin ligjor në lidhje me mbajtjen e tubimeve publike. Madje, një numër i konsiderueshëm i komunave kanë mbajtur numër më të madh se sa është paraparë sipas ligjit.

Kërkesat e qytetarëve për qasje në dokumentet zyrtare

Vlerësimi i gjendjes aktuale – Në shumë Komuna fare nuk ka pasur kërkesa për qasje në dokumentet zyrtare. Në lidhje me këtë në vijim paraqesim numrin e kërkesave për qasje në dokumente në komunat, të cilat kanë pranuar këtë kategori të kërkesave. 95 Kërkesa ka pasur Komuna e Kaçanikut; Klina 16; Prishtina 9; komuna e Mitrovicës, Suharekës, dhe e Prizrenit kanë pasur nga 7 kërkesa ; 5 kërkesa ka pasur komuna e Kamenicës; Gjilani dhe Peja nga 3 kërkesa kanë pranuar; Ferizaj 2 kërkesa, 1 kërkesë ka pasur Komuna e Vitisë, Shtërpcës, Skenderajt dhe e Lipjanit; ndërsa një kërkesë tjetër nga një OJQ ka pasur komuna e Gjakovës.

Komunat e tjera nuk kanë pasur ndonjë kërkesë për qasje në dokumentet zyrtare.

Peticionet e qytetarëve drejtuar komunës

Kuvendit të Komunës së Gjakovës, Drenasit, Vushtrrisë, Gjilanit, Dragashit, Lipjanit i është paraqitur nga një 1 kërkesë. Kuvendit Komunal të Obiliqit i janë drejtuar 4 peticione të cilat janë shqyrtuar. Suharekës i është paraqitur 1 kërkesë dhe një peticion e cili është aprovuar nga kuvendi i komunës. Në Fushë Kosovë janë paraqitur 2 peticione

të cilat janë shqyrtuar. Shtimes i është paraqitur një peticion i cili gjithashtu është shqyrtuar. Kurse në Komunën e Prizrenit, Malishevës, Deçanit, Podujevës, Shtërpcës, Hanit të Elezit, Prishtinës, Junikut, Ferizajt, Novobërdës, Mamushës, Istogut, Klinës, Pejës, Skënderajt, Rahovecit, Kaçanikut dhe Vitisë nuk ka pasur peticione të paraqitura.

Aktet juridike të Komunës

Vlerësimi i gjendjes aktuale në Komuna - Pas miratimit të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale është paraqitur nevoja për ndryshimin e statuteve komunale aktuale.

Në shumicën e komunave janë formuar komisionet për ndryshimin dhe hartimin e statuteve në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Deri në fazën e raportimit këto komuna i kanë miratuar statutet:
Dragashi (11.09.08), Fushë Kosova (15.10.08), Deçani (31.10.08), Kamenica (26.09.08), Vitia (15.10.08), Shtimja (03.07.08), Prizreni (15.10.08- i kthyer në ri-shqyrtim), Lipjani (26.09.08), Malishevë (31.10.08), Suhareka (04.11.08), Gjakova (26.12.08), Mitrovica (12.11.08), Vushtrria (30.10.08), Gjilani, Skenderaj, Rahoveci, Obiliqi, Hani Elezit, Drenasi, Juniku, Ferizaj, Novobërda, Mamushë, Istogu, Klina, Kaçaniku, Peja, ndërsa Podujeva, Prishtina dhe Shtërpca nuk e kanë miratuar statutin**.**

Përveç statutit, komunat kanë miratuar edhe rregullore të tjera nga fusha të ndryshme të veprimtarisë së komunës, nga përgjegjësitë dhe kompetencat që iu takojnë, si dhe në bazë të nevojës për harmonizimin me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Gjatë vitit 2008 komunat kanë miratuar këtë numër të rregulloreve:

Deçani ka miratuar 5 Rregullore, Dragashi 4, Kamenica 4, Vitia 4, Mitrovica 4, Suhareka 4, Fushë Kosova 3 Shtime, Lipjani 3, Gjakova 3 Prizreni 3, Malisheva 2, Vushtrria 2, Peja 7, Gjilani 6, Skenderaj 5, Prishtina, Juniku, Istogu, Klina 3, Obiliqi, Novobërda 4, Rahoveci, Drenasi, Ferizaj, Mamusha, Kaçaniku 2, Hani Elezit 1, Podujeva dhe Shtërpca nuk ka të miratuar asnjë Rregullore.

Rregullorja Komunale për Gjuhët

Rregullore komunale për gjuhët kanë këto komuna: Suhareka, Fushë Kosova , Obiliqi, Novobërda, Mamusha, Klina, Peja,dhe Prizreni. Komunat tjera ende nuk e kanë miraturë këtë rregullore.

Konkluzion:
Një numër i konsiderueshëm i Komunave kanë miratuar statutet e tyre dhe i kanë harmonizuar me LVL. MAPL në vazhdimësi ka përkrahur komunat në lidhje me miratimin e statuteve të Komunave duke pasur parasysh se komunave i është dashur që brenda një viti të ndryshojnë statutet e tyre dy herë, për shkak të ndryshimeve në legjislacionin që ka të bëjë me kompetencat e Komunave.

Drejtoritë Komunale

Vlerësimi i gjendjes aktuale në Komuna - Numri i drejtorive në komuna është pasqyruar si vijon: 12 drejtori Vushtria, 11 drejtori Prizreni; 10 drejtori Fushë Kosova, Lipjani, Mitrovica, Gjakova, Ferizaj, Gllogoc; 9 drejtori Deçani, Suhareka, Rahoveci, Peja; 8 drejtori Vitia, Malisheva, Dragashi, Obiliqi, Prishtinë, Istogu, Klina; 7 drejtori Kaçaniku, Novobërda, Skënderaj; 6 drejtori Kamenica, Shtimja, Shtërpca, Hani i Elezit, Juniku; 5 drejtori Podujeva; 4 drejtori Mamusha.

Konkluzion:
Me hyrjen në fuqi të LVL, duke pasur parasysh se nuk ka kufizime në numrin e drejtorive komunale, këto probleme janë evituar, meqenëse është në kompetencë të komunës që sipas nevojave specifike të caktojë edhe numrin e drejtorive.

Raportimi i Kryetarit të Komunës para Kuvendit Komunal

Vlerësimi i gjendjes aktuale në Komuna - Kryetari i komunës së Skenderajt ka raportuar katër herë para kuvendit, nga 3 herë kanë raportuar kryetari i komunë së Gjakovës, Lipjanit, Gjilanit dhe Fushë Kosovës, 2 herë ka raportuar kryetari i komunës së Vushtrrisë, Podujevës, Rahovecit, Obiliqit, Prishtinës, Drenasit, Junikut, Ferizajt, Novobërdës, Mamushës, Istogut, Klinës, Kaçanikut, Mitrovicës, Suharekës, Malishevës, Prizrenit, Kamenicës, Deçanit, një herë ka raportuar kryetari i komunë së Vitisë, Pejës dhe Dragashit ndërsa kryetari i komunës së Shtimes, Hanit të Elezit dhe Shtërpcës nuk ka raportuar asnjëherë.

Konkluzion:
Në të gjitha komunat raportimi i Kryetarit është bërë në formë të informatës me shkrim.

Funksionimi i faqeve zyrtare të internetit në Komuna

Vihet re se ka përmirësim të funksionimit të Ueb faqeve në krahasim me periudhat e mëhershme. Përveç komunave të Fushë Kosovës, Shtërpcës, Hanit të Elezit, Novobërdës, Mamushës dhe Dragashit, të cilat nuk i kanë funksionale faqet e internetit, në të gjitha komunat e tjera këto faqe janë funksionale.

Gjendja me Planin zhvillimor komunal dhe planin zhvillimor urban

Kuvendet e Komunave janë përgjegjëse për miratimin e planit zhvillimor komunal, planit zhvillimor urban dhe planit rregullativ urban. Gjendja në komuna sa i përket miratimit të këtyre planeve është si vijon:

Kuvendet e Komunave të Kamenicës, Gjakovës, Suharekës, Gjilanit, Junikut, Klinës, Pejës dhe Lipjanit kanë të miratuar **planin zhvillimor komunal** dhe **planin zhvillimor urban**.

Komunat e Skënderajt, Rahovecit, Obiliqit, Hanit të Elezit, Gllogocit, Ferizajt, Novobërdës, Mamushës, Istogut dhe Kaçanikut **nuk e kanë miratuar Planin zhvillimor urban dhe atë komunal**.

Kuvendi i Komunës së Deçanit e ka miratuar, por pritet pëlqimi i MMPH;
Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë është në fazën e diskutimit në kuvend;
Kuvendi i Komunës së Vitisë në fazën e fillimit të punimeve;
Kuvendi i Komunës së Mitrovicës në fazën e diskutimit publik;
Kuvendi i Komunës së Shtimes në fazën e zgjedhjes së këshillit të ekspertëve;
Kuvendi i Komunës së Prishtinës ka në miratuar planin zhvillimor urban, kurse plani zhvillimor komunal është në miratim e sipër;
Kuvendi i Komunës së Shtërpcës i ka miratuar por pritet pëlqimi i Ministrisë;

Ndërsa Kuvendi i Komunës së Malishevës, Podujevës, Dragashit, dhe Fushë Kosovës nuk i kanë miratuar këto plane.

EFIKASITETI DHE AZHURITETI I ORGANEVE ADMINISTRATIVE

Pjesa e dytë e këtij raporti paraqet analizën në lidhje me efikasitetin dhe azhuritetin e organeve komunale në procesin administrativ. Ky raport është vazhdimësi e raporteve paraprake, ndërsa analizimi i këtyre aktiviteteve ka filluar që nga viti 2006 në baza gjashtë mujore.
Qëllimi kryesor i vlerësimit të efikasitetit dhe azhuritetit është njohja me gjendjen reale të organeve të administratës komunale në shqyrtimin e lëndëve në procedurë administrative.

Raporti prezanton të dhënat të cilat kanë dërguar komunat në MAPL lidhur me efikasitetin dhe azhuritetin e organeve të 29 komunave. Në raport do të bëhet edhe krahasimi i gjendjes me dy periudhat paraprake (viti 2007 dhe 2008), me qëllim që të krahasohet rritja apo rënia e efikasitetit të punës së organeve të komunave në periudha të ndryshme.

Emërtimi i paunifikuar i drejtorive në komuna ka paraqitur vështirësi për të bërë krahasimin e të dhënave të drejtorive të njëjta nga komuna në komunë, mirëpo një krahasim i efikasitetit të organeve të komunave është bërë për dy periudha të ndryshme kohore dhe atë për vitin 2007 dhe 2008.

Vihet re se ka pasur një ulje të lëndëve të shqyrtuara në komuna në vitin 2008, në krahasim me vitin 2007. Si total, në vitin 2008 ka pasur 186 269 lëndë të shqyrtuara, në krahasim me 372 848 lëndë të shqyrtuara gjatë vitit 2007.

Në krahasim me të dhënat e vitit 2007, mund të bëjmë një grupim të tillë të komunave:

- Komuna ku janë shtuar kërkesat dhe parashtresat: Deçan, Ferizaj, Gjilan, Gllogoci, Lipjani, Novobërda, Mamusha, Klina.

- Komuna që kanë pasur rënie të kërkesave dhe parashtresave, madje në mënyrë të ndjeshme: Kamenica, Peja, Hani i Elezit, Prishtina, Mitrovica, Juniku, Skënderaj, Vushtria.
- Komuna që kanë një numër përafërsisht të njëjtë të kërkesave dhe parashtresave: Dragashi, Prizreni, Suhareka.

Konkluzione

Të dhënat e paraqitura në raport në lidhje me efikasitetin dhe azhuritetin në komuna, kryesisht rezultojnë të pasakta;

Të dhënat në zyrën pritëse në shumicën e Komunave nuk azhurnohen me kohë;

Sistemi digjital (Intraneti) në zyrën pritëse në Komunë është i instaluar, por të dhënat nuk freskohen dhe ka vështirësi në kthimin e dokumentacionit në këtë zyrë;

Në librat e protokollit të shkurtër evidentohen pranimet e kërkesave, ndërsa pas shqyrtimit të kërkesës, Libri i protokollit nuk plotësohet, por për kërkesat dhe parashtresat e qytetarëve, mbahen libra të brendshëm nëpër drejtori;

Pavarësisht se përfaqësuesit e komunave, kanë nënshkruar deklaratën e saktësisë së të dhënave gjatë mbushjes së pyetësorëve në takimet e përbashkëta me ekipet e monitorimit të MAPL-së, gjatë evidentimit të gjendjes në terren, të dhënat kryesisht rezultojnë të pasakta.

PROMOVIMI DHE RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË NJERIUT NË NIVEL KOMUNAL

Themelimi i njësive për të drejtat e njeriut në nivelin Lokal

Vlerësimi i gjendjes aktuale - Në 26 komuna janë themeluar njësitë për të drejtat e njeriut (NJDNJK) dhe në përgjithësi janë kompletuar dhe me numrin përgjegjës të personelit. NJDNJK-ja, bazuar në nenin 6.1 të UA Nr. 2008/02, ka tre anëtarë, koordinatorin, zyrtarin për barazi gjinore, për komunitete dhe zyrtarin për të drejta të fëmijëve. Për shkak të pamundësisë së rekrutimit të stafit dhe buxhetit të kufizuar, komunat kanë themeluar njësitë nga stafi ekzistues, në përputhje me nenin 6.2 të UA 2008/02.
Një numër prej 22 komunash ka siguruar zyra për ta, ndërsa në katër komuna të tjera kjo pjesë e stafit ka mbetur pjesë e drejtorive të tjera, për arsye se në të njëjtën kohë janë zyrtarë në departamentin e arsimit apo në zyrën lokale të komuniteteve.

Koordinatori i Njësisë për të Drejtat e Njeriut

Në 19 komuna koordinator i njësisë është emëruar zyrtari për barazi gjinore, i cili mbulon edhe fushën e mundësive të barabarta, duke pasur parasysh se kjo kategori e zyrtarëve komunalë kanë përvojë në fushën e të drejtave të njeriut. Në disa Komuna, koordinatori njëkohësisht mbulon edhe një resor të caktuar nga fusha e kompetencave të Komunave. Në tri komuna, konkretisht në Mitrovicë, Skenderaj dhe Dragash, koordinatori i njësisë mbulon edhe fushën e të drejtave të fëmijëve, ndërsa në komunën e Rahovecit, koordinatori i njësisë në të njëjtën kohë është edhe zyrtar për integrime evropiane.

Koordinatorët e 19 komunave janë të pajisur me kontratë pune sipas Ligjit mbi Shërbimin Civil, ndërsa 7 koordinatorë kanë kontratë në përputhje me UA 2008/02.

Përfshirja e NJDNJK-së në strukturën organizative të komunës

Shumica e Njësive për të drejtat e njeriut janë të përfshira në kuadër të drejtorisë së administratës, por ka edhe njësi që i përgjigjen kryetarit.

Komunat Prizren, Malishevë, Vushtri, Podujevë, Ferizaj dhe Suharekë kanë siguruar mjete të mjaftueshme për zhvillimin e aktiviteteve të NJDNJK-së, ndërsa 19 komuna nuk kanë specifikuar mjetet buxhetore në lidhje me aktivitetet e këtyre njësive për vitin 2009. Ndonëse NJDNJK-të kanë qenë në fazën e konsolidimit dhe të ndërtimit të kapaciteteve profesionale gjatë këtij viti, ato kanë realizuar aktivitete të ndryshme nga të gjitha fushat e të drejtave të njeriut, me qëllim rritjen e vetëdijes së zyrtarëve të administratës komunale dhe qytetarëve për barazinë gjinore, mundësitë e barabarta, të drejtat e fëmijëve, të drejtat e minoriteteve dhe personave me aftësi të kufizuar. Bëjnë përjashtim nga ky aktivitet i ngjeshur i njësiteve komunat e Dragashit dhe Novobërdës.

Përfshirja e minoriteteve në komuna

Në të gjitha komunat ka pjesëtarë të komuniteteve të ndryshme, të përfaqësuar si në stafin politik, ashtu dhe në strukturat e tjera komunale. Njësitë për të drejtat e njeriut në komuna janë struktura heterogjene dhe multietnike. Sipas të dhënave në dispozicion, në lidhje me numrin e të kthyerve nga vendet e treta, komunat kanë këtë numër të të kthyerve: Prizreni 23 persona, Shtimja 1 familje nga Maqedonia, Kamenica 10 familje serbe, Deçani 3 persona, Peja 65 persona, Lipjani 19 persona, Istogu 20 persona, Skënderaj 1 person, Prishtina janë dorëzuar kërkesat për kthimin e 17 familjeve serbe, rome e boshnjake, Dragash 122 familje, Ferizaj 166 persona (romë e ashkali), Vitia 4 persona (serb), Gjakova 404 persona, Klina 69 persona, Vushtria 3 persona (ashkali). Ndërsa nga komunat Novobërdë, Obiliq, Drenas, Kaçanik, Mitrovicë, Malishevë, Gjilan, Podujevë, Rahovec dhe Suharekë nuk ka qenë e mundur të sigurohen të dhëna në lidhje me numrin e të kthyerve.

Përdorimi i gjuhëve

Të gjitha dokumentet që nxjerrë komuna, përkthehen në gjuhët zyrtare, sipas Ligjit mbi përdorimin e Gjuhëve, mirëpo disa prej tyre, varësisht prej kërkesave të qytetarëve përkthehen edhe në gjuhën e kërkuar, gjegjësisht në gjuhën në përdorim zyrtar.

Konkluzione:

Mund të konsiderojmë se në komuna tashmë është krijuar dhe funksionon një mekanizëm për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Funksionalizimi i mëtejshëm i NJDNJK-ve do të lehtësojë zbatimin e politikave, strategjive dhe planeve të veprimit të aprovuara nga Qeveria e Kosovës, si dhe mirëfunksionimin e vetë komunave.

RAPORTI I TË HYRAVE DHE SHPENZIMEVE TË BUXHETEVE KOMUNALE

Të hyrat vetanake të komunave

Shikuar në tërësi të gjitha komunat e Kosovës në këtë dymbëdhjetë mujor kanë rritje të hyrave vetanake në krahasim me vitin e kaluar. Në strukturën e të hyrave vetanake, të hyrat nga tatimi në pronë si dhe të hyrat komunale për leje ndërtimi kanë një rritje të theksuar, ndaj kjo rritje është inkurajuese.

Planifikimi i të hyrave për vitin 2008 krahasuar me vitin 2007 në total është me i madh për 33.93%. Pothuajse të gjitha komunat kanë planifikuar të hyra me shumë në vitin 2008 se sa në vitin 2007 me theks të veçantë: Hani i Elezit në vitin 2008 ka planifikuar 93,400€, ndërsa ne vitin 2007 - 20,000€ ose 367% me shume në vitin 2008 se sa në vitin 2007, Prishtine në vitin 2008 ka planifikuar 14,000,000€, ndërsa në vitin 2007 - 7,000,000€ ose 100% më shume në vitin 2008 se sa ne vitin 2007, Junik gjithashtu në vitin 2008 ka planifikuar 40,000€, ndërsa ne vitin 2007 - 20,000€ ose 100% me shume në vitin 2008 se sa në vitin 2007, ndërsa komunat të tjera vazhdon si vijon: Gllogoc (13.50%), Lipjan (12.31%), Obiliq (10%), Shtime (26,65%), Dragash (17,39%), Prizren (10,51%), Rahovec (10,62%), Suhareke (24,71%), Malisheve (35,85%), Gjakovë (10,83%), Istog (17,70), Kline (6,92), Peje (27,54%), Mitrovice (20,21%), Vushtrri (1.79), Gjilan (10%), Novobërdë (18%), Shtërpcë (14,35%), Ferizaj (13,77%). Shtatë komuna mbesin në nivelin e njëjtë të planifikimit si: Podujeve, Deçan, Kamenice, Viti, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan.

Duhet theksuar se në tri komuna të Republikës se Kosovës në vitin 2008 planifikimi është më i vogël se në vitin 2007 dhe atë: Fushe Kosovë planifikimi për vitin 2007 është 700,000,00 ndërsa në vitin 2008 është 650,000.00 d.m.th për 7.14% më i vogël se në vitin 2007, Skenderaj planifikimi për vitin 2007 është 470,000,00 ndërsa ne vitin 2008 është 435,000.00 d.m.th për 7.45% më i vogël se në vitin 2007, dhe Kaçanik planifikimi për vitin 2007 është 350,000,00 ndërsa në vitin 2008 është 268,250.00 d.m.th për 23.36% me i vogël se në vitin 2007.

Bazuar nga të dhënat e free balancit komunat e Kosovës gjatë periudhës dymbëdhjetë mujore të vitit 2008 kanë grumbulluar 42,702,140.22€ të hyra vetanake, ose 113.87% nga niveli i planifikuar vjetor (37,500,000.00 €).

Është inkasuar tatimi në pronë në shumë prej 12,695,862.68 €, dukshëm më shumë sesa në periudhën dymbëdhjetë mujore të vitit 2007 (8,328,474.00 €).

Komunat të cilat kanë realizuar më së shumti të hyra vetanake ne vitin 2008 janë: Lipjani (178.76%) i cili ka realizuar një përqindje më të lartë të të hyrave vetanake për këtë dymbëdhjetë pastaj vijojnë komunat tjera: Kaçanik (164.21%), Fushë Kosovë (151.20%), Gjakovë (148.26%), Vushtrri (145.81%), Gllogoc (136.77%), Kamenicë (129.26%), Skenderaj (121.61%), Obiliqi (120.73%), Pejë (117.89%), Ferizaj (115.35%), Prishtinë (115.12%), Juniku (111.72%), Hani i Elezit (108.29%), Gjilani (106.23%), Dragashi (106.04%), Vitia (104.79%), Istogu (103.89%), Suhareka (102.95%), Deçan (100.80%), Mitrovicë (100.60%), Prizren (100.20%).

Komunat që kanë realizuar të hyra vetanake ne një shkalle me te ulet se planifikimi janë: Klinë (97.84%), Podujevë (97.48%), Rahovec (94.87%), Shtime (76.55%), Malisheva (70.50%), Mamushë (62.07%), Novobërdë (52.97%) dhe Shtërpca (22.95%).

Komunat e Veriut të Kosovës, ashtu si edhe në vitet e kaluar, edhe në këtë periudhë nuk kanë realizuar të hyra vetanake.

Krahasuar me periudhën janar- dhjetor 2007 indeksi i realizimit për vitin 2008 është 10.09% në total për të gjitha komunat.

Raport i shpenzimeve të buxheteve komunale

Sipas të dhënave të free-balancit te datës 23.01.2009, komunat e Kosovës për periudhën janar-dhjetor 2008 i kanë shpenzuar buxhetet e tyre në vlerë të përgjithshme prej 200,612,737.89 €, ose 90% të buxhetit të planifikuar vjetor (pas rishikimit buxhetor) prej 221,938,678.79€.

Planifikimi në kategorinë e pagave dhe shtesave në shumë prej 113,997,290.51 € është shpenzuar në vlerë prej 112,418,677.69 €, ose 99% i nivelit vjetor; mallra dhe shërbime të planifikuara në vlerë prej 27,597,967.58 € janë shpenzuara 26,022,698.87 € ose 94%, shpenzimet komunale te planifikuara në shumë prej 7,698,490.32 € janë shpenzuar në vlerë prej 7,684,113.07 €, ose 100 %; subvencione dhe transfere të planifikuara vlerë prej 3,609,881.90 € është shpenzuar në vlerë prej 3,343,881.96 € ose 93%; ndërsa shpenzime kapitale te planifikuara ne vlerë prej 69,038,048.48 €, është shpenzuar 51,143,366.30 €, ose 74%.

Lista e shkurtimeve:

DVL – Departamenti për Vetëqverisje Lokale

LVL - Ligji për vetëqeverisje Lokale

MAPL - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

NJDNJ - Njësitë për të drejtat e njeriut

NJDNJK - Njësitë për të drejtat e njeriut në Komuna

PNJK - Pilot Njësi komunale

UA - Udhëzim Administrativ

UNMIK- Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

Hyrje

Ministria e Administrimit të pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj ligjor, mbështet dhe mbikëqyr në vazhdimësi aktivitetet e Komunave. Kjo konsiston në promovimin e qeverisjes së mirë, respektimin e parimeve demokratike sipas kushtetutës, ligjit dhe Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale.

Ndryshimet themelore në sistemin politik dhe ekonomik janë shoqëruar nga një reformë të plotë ligjore që synon të krijojë një sistem ligjor në përputhje me kërkesat e pluralizmit demokratik, sundimit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut.

Në vitin 2008, shtatë vjet pas krijimit të sistemit të vetëqeverisjes lokale në Kosovë, UNMIK-u shpalli rregulloren 2007/27 "Mbi Zgjedhjet Komunale në Kosovë", e cila, për herë të parë pas vendosjes së administratës civile ndërkombëtare, krijoi bazën ligjore për mbajtjen e zgjedhjeve të drejtpërdrejta për Kryetarët e Komunave dhe Kuvendet komunale dhe që reflektoi direkt në ndryshimet e legjislacionit nga fusha e qeverisjes lokale.

Në lidhje me këtë, me rregulloren 2007/30 u ndryshua rregullorja e UNMIK-ut 2000/45 "Mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës" e cila ka qenë bazë për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes lokale që nga viti 2000. Me këtë rregullore u rritën përgjegjësitë dhe forcohet autoriteti i Kryetarit të Komunës si organi më i lartë ekzekutiv i zgjedhur drejtpërdrejtë nga qytetarët e komunës me të drejtë vote, që njëkohësisht konsiderohet të jetë hapi i parë drejt reformimit të pushtetit lokal.

Me hyrjen në fuqi të rregullores 2007/30 për ndryshimin e rregullores 2000/45 për vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës u parashikuan një numër i konsiderueshëm i ndryshimeve, që kanë ndryshuar në mënyrë thelbësore organizimin dhe funksionimin e komunës.

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës dhe hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës, u hodh edhe hapi i dytë drejt reformës dhe avancimit të autonomisë së Komunave. Në qershor të vitit 2008, pasoi hyrja në fuqi e një numri të konsiderushëm të Ligjeve, të cilat shënojnë në një mënyrë edhe kompletimin e infrastrukturës ligjore në Kosovë, sipas detyrimeve që kishte sjellë dokumenti gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës (Dokumenti i Ahtisarit).

Konkretisht, Ligji për Vetëqeverisje Lokale, përkufizon statusin ligjor të komunave, kompetencat dhe parimet e përgjithshme të financave komunale organizimin dhe funksionimin e organeve komunale, marrëdhëniet brendakomunale dhe bashkëpunimin ndërkomunal, duke përfshirë

bashkëpunimin ndërkufitar dhe marrëdhëniet ndërmjet komunave dhe pushtetit qendror.

Edhe LVL parasheh sistemin njëshkallësh të qeverisjes lokale, ku Komuna përcaktohet si njësi themelore e vetëqeverisjes lokale, e përbërë nga një komunitet i qytetarëve në një territor të caktuar, të përcaktuar me ligj, e cila ushtron tërë pushtetin i cili nuk është i rezervuar shprehimisht për institucionet qendrore. Duhet theksuar se statusi ligjor i Komunës organet e Komunës dhe aktet që nxjerrë Kuvendi i Komunës nuk ndryshojnë ecencialisht, në krahasim me rregulloren 2007/30.
Në këtë drejtim, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), në përmbushje të mandatit të saj ligjor për të avancuar vetëqeverisjen lokale në Kosovë, ka përgatitur këtë raport që pasqyron gjendjen e funksionimit të Komunave për periudhën Janar-Dhjetor 2008, duke përfshirë Raportin mbi funksionimin e Kuvendeve të Komunave, Raportin mbi efikasitetin dhe azhuritetin e organeve administrative komunale, Raportin në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut dhe funksionalizimin e njësiteve për të drejtat e njeriut në nivelin lokal, si dhe Financat lokale, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet e komunave për këtë periudhë kohore.

Qëllimi i hartimit të raportit

Qëllimi i raportit është të hulumtojë situatën aktuale dhe sipas të dhënave të grumbulluara, të pasqyrojë gjendjen reale në lidhje me funksionimin dhe aktivitetet e Komunave.

Raporti mund të konceptohet si një përmbledhje në lidhje me veprimtarinë e komunave dhe trajton disa nga çështjet kryesore që lidhen me funksionimin dhe qeverisjen e mirë në nivelin komunal. Raporti përmban të dhëna statistikore, të dhëna krahasimore ndërmjet viteve, konstatime të gjendjes aktuale, konkluzione në lidhje me respektimin e legjislacionit në fuqi dhe rekomandime përkatëse për funksionim më të mirë të organeve komunale, në mënyrë që qytetarëve, mediave, dhe institucioneve tjera relevante t'u shërbejë si një tregues në lidhje me përmbushjen e detyrimeve ligjore të komunave, njëkohësisht, edhe vetë Komunat të shohin krahasimet eventuale ndërmjet vete, që mund të ndikojë në unifikimin e proceseve në drejtim të përmbushjes sa më të mirë të obligimeve në raport me qytetarët.

Struktura e raportit

Raporti përmban përmbledhjen ekzekutive; hyrjen; metodologjinë e punës dhe pjesën përmbajtësore të ndarë në katër pjesë:

- Pjesa e Parë: Funksionimi i Kuvendeve të Komunave;
- Pjesa e dytë: Funksionim i administratës komunale;
- Pjesa e tretë: Respektimi i të drejtave të njeriut në nivelin komunal; dhe
- Pjesa e katërt: Raporti i të hyrave dhe shpenzimeve të buxheteve Komunale.

Raporti është hartuar në një mënyrë të tillë, ku problemet në lidhje me detyrimet ligjore të komunave trajtohen duke paraqitur fillimisht sfondin ligjor, më pas evidentimin e gjendjes reale, konluzionet në lidhje me aktivitetet e Komunave dhe së fundi rekomandimet e përgjithshme në lidhje me përmirësimin e situatës.

Metodologjia e punës

Raporti i funksionimit të Komunave është bazuar në këtë metodologji pune:

Faza e parë:
Hartimi i pyetësorit dhe shpërndarja e tyre nëpër komuna

Departamenti për Vetëqeverisje Lokale ka hartuar pyetësorin, i cili është vënë në dispozicion të Departamenteve të tjera, kabinetit të Ministrit dhe projekteve ndërkombëtare që mbështesin MAPL-në, për të dhënë komentet dhe sugjerimet. Versioni final i pyetësorit përmbante pyetjet kryesore që lidhen me kompetencat e komunave, kryesisht të ndara në fushat sipas strukturës që ka raporti.

Faza e dytë:
Grumbullimi i të dhënave nga terreni

Me qëllim të pasqyrimit të aktiviteteve të komunave në mënyrë sa më reale, MAPL këtë herë ka ndryshuar sistemin e mbledhjes së të dhënave dhe metodologjinë e hartimit të raportit për komunat. Për ndryshim nga e kaluara, versioni final i përmbledhjes së pyetjeve nga fusha të ndryshme është dërguar paraprakisht dhe në komuna. Në një afat optimal kohor, komunat kanë pasur mundësinë të njihen me pyetjet, ndërsa në datën e caktuar, një në takim të përbashkët ndërmjet zyrtarëve të MAPL-së dhe Zyrtarëve të Komunave është plotësuar versioni final i formularit. Në këtë mënyrë, Komunat kanë pasur në dispozicion kohë të mjaftueshme që të paraqesin të dhënat e tyre, ndërsa ekipet e MAPL-së nuk kanë qenë të obliguar që pas përgatitjes së raportit përfundimtar të dalin edhe njëherë në terren me qëllim verifikimin e të dhënave.

Në komunat ku është zgjedhur kryesuesi, për funksionimin e Kuvendit të Komunës, të dhënat janë siguruar nga kryesuesi.

Sa i përket të dhënave në lidhje me shërbimet administrative komunale është kontaktuar drejtori i Administratës dhe personelit. Në raste të caktuara dhe sipas nevojës janë kryer edhe takime me drejtorë të tjerë të administratës së Komunës, sipas fushave specifike.

Që të sigurohen të dhënat në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut në nivelin lokal, janë kontaktuar koordinatorët e njësive për të drejtat e njeriut në Komuna.

Me qëllim të realizimit të planit të veprimit për mbledhjen e të dhënave, Departamenti për Vetëqeverisje Lokale ka formuar 4+1 ekipe monitoruese, që në afatin e përcaktuar kanë vizituar gjithsej 29 Komuna, me përjashtim të katër Komunave ku komuniteti serb është shumicë (ku pavarësisht se në të njëjtën mënyrë janë dërguar pyetësorët, nuk kemi pasur ndonjë përgjigje).

Faza e tretë:

Verifikimi i të dhënave dhe plotësimi i tyre sipas të dhënave që MAPL ka në dispozicion

Pas grumbullimit të të dhënave është bërë sistemimi i tyre sipas fushave. Ndërsa të dhënat janë verifikuar dhe janë krahasuar edhe me raportet e monitorimeve të rregullta të ekipeve monitoruese të MAPL-së, që janë siguruar gjatë monitorimit të seancave të kuvendeve.

Gjithashtu, një numër i konsiderueshëm i të dhënave, është marrë edhe nga vizitat monitoruese të cilat janë realizuar sipas planit të vizitave në terren nga stafi i lartë udhëheqës i MAPL-së, në përbërje të Zv. Ministrave, dhe stafit të lartë udhëheqës të shërbimit civil.

Faza e katërt

Për shkak se gjatë sistemimit dhe verifikimit të të dhënave në lidhje me shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave në procedurë administrative, është vënë re se një numër i konsiderueshëm i të dhënave në disa Komuna ka pasur pasaktësi, ekipet e MAPL-së kanë hartuar një plan të vizitave monitoruese në gjashtë

Komuna me qëllim që të verifikohen të dhënat. Në këtë fazë ekipet monitoruese kanë verifikuar të dhënat, në mënyrë që raporti të pasqyrojë gjendjen reale ekzistuese në Komuna.

Faza e pestë

Pas verifikimit të të dhënave në terren, janë bërë përmirësimet e nevojshme dhe është përgatitur versioni final i raportit , sipas të dhënave në dispozicion.

PJESA E PARË

FUNKSIONIMI I KUVENDEVE TË KOMUNAVE

Funksionimi i Kuvendeve të Komunave

Hyrje:

Raporti pasqyron aktivitetin e Kuvendeve të Komunave, duke u fokusuar në seancat inauguruese të kuvendeve komunale, mbledhjet e Kuvendit Komunal, formimin e komiteteve obligative, formimin e komiteteve të tjera, tubimet publike me qytetarët, kërkesat e qytetarëve për qasje në dokumentet zyrtare, rregulloret e miratuara gjatë kësaj kohe, përgatitjen e statuteve komunale, strukturën e drejtorive të Komunës, raportimin e Kryetarit të Komunës para Kuvendit, shqyrtimin e raportit financiar për vitin paraprak, dhe funksionimi i faqeveve zyrtare të internetit në komuna, duke i pasqyruar ato në kontekstin e respektimit të rregullores 2007/30 dhe Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale.

Edhe me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale (LVL), ashtu siç është rregulluar me Rregulloren 2007/30, sistemi i qeverisjes lokale është organizuar në një shkallë. Statusi ligjor i Komunës dhe organet e Komunës dhe aktet që nxjerrë Kuvendi i Komunës nuk ndryshojnë rrënjësisht.

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, komunat i ushtrojnë kompetencat e tyre sipas parimit të subsidiaritetit. Dallimi kryesor i LVL dhe Rregullores 2007/30 konsiston në ushtrimin e kompetencave të Komunës, ku përveç kompetencave vetanake dhe të deleguara, kanë edhe kategorinë e kompetencave të zgjeruara.

Rregullorja e UNMIK-ut 2007/30 për ndryshimin e rregullores 2000/45 mbi Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë, nuk i ndryshoi esencialisht përgjegjësitë e Kuvendit të Komunës, por ndryshoi marrëdhëniet ndërmjet kuvendit dhe organeve të tjera të komunës. Në bazë të Rregullores 2007/30, mbledhjet e Kuvendit të Komunës kryesoheshin nga Kryetari i Komunës i cili zgjidhej drejtpërsëdrejti nga qytetarët e Komunës. Me rregulloren 2007/30, përveç tre komiteteve të përhershme, Kuvendi i Komunës themelon edhe komitete të tjera të obligueshme si: komitetin për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, komitetin për arsim dhe kulturë, komitetin për zhvillim ekonomik, komitetin për planifikim urban, kadastër dhe mbrojtje të mjedisit.

Edhe me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale gjithashtu nuk kanë ndryshuar ecencialisht përgjegjësitë e kuvendit të komunës. Dallimi kryesor është përcaktimi i kriterit të popullsisë për numrin e anëtarëve në Kuvendin e Komunës. Gjithashtu, me LVL është paraparë edhe pozita e re e kryesuesit të Kuvendit të Komunës, për dallim me Rregulloren 2007/30 ku Kryetari i Komunës ishte edhe kryesues i Kuvendit të Komunës.

Mbledhjet e Kuvendeve të Komunave

Sfondi Ligjor- Sipas rregullores 2007/30, Kuvendet Komunale i zhvillonin punimet në mbledhje të rregullta dhe të jashtëzakonshme. Sipas nenit 15 të Rreg. 2007/30, Kuvendi i Komunës mblidhej sa herë që kjo parashihej me Rregulloren e punës, por duhet të mbante së paku dhjetë mbledhje brenda vitit fiskal. Mbledhjet parimisht thirreshin nga Kryetari i Komunës, së paku 7 ditë pune para mbajtjes së mbledhjes së rregullt dhe 3 ditë pune para mbajtjes së mbledhjes urgjente.

Në këtë pikë dallon Ligji për Vetëqeverisjen Lokale. Tani mbledhjet thirren nga Kryesuesi i Komunës. Sipas nenit 41.1. Kuvendi i Komunës, zgjedh nga radhët e veta kryesuesin. Ndërkohë, edhe sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Kuvendet Komunale i zhvillojnë punimet në mbledhje të rregullta dhe të jashtëzakonshme. Sipas nenit 43 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Kuvendi i Komunës mblidhet sa herë që kjo parashihet me Rregulloren e punës dhe duhet të mbajë së paku dhjetë mbledhje në vit, pesë prej të cilave duhet të mbahen gjatë gjashtë mujorit të parë, që gjithashtu ndryshon nga rregullorja 2007/30. Mbledhjet thirren së paku 7 ditë pune para mbajtjes së mbledhjes së rregullt dhe 3 ditë pune para mbajtjes së mbledhjes urgjente.

Vlerësimi i gjendjes aktuale në Komuna - Në shumicën e Komunave, Kuvendet janë funksionale dhe e zhvillojnë veprimtarinë e tyre normalisht, përveç komunës së Novobërdës dhe Shtërpcës, të cilat kanë probleme në funksionalizimin e tyre për arsye politike. Ndërsa gati në të gjitha komunat, materialet për pikat e rendit të ditës së mbledhjes iu dërgohen anëtarëve të Kuvendit sipas afateve të përcaktuara me ligj.

Konkretisht, gjatë vitit 2008 Kuvendet e Komunave kanë mbajtur mbledhje të rregullta si në vijim: 14 mbledhje ka mbajtur Mitrovica, 12 mbledhje Deçani, Shtimja, Lipjani, Prizreni, Prishtina, Mamusha, 11 mbledhje ka mbajtur Malisheva, Suhareka, Gjilani, Rahoveci, Ferizaj, Peja, dhe Vushtrria; 10 mbledhje Gjakova, Vitia, Kamenica, Fushë Kosova, Dragashi, Skenderaj, Hani i Elezit, Gllogoci, Juniku, Istogu, Klina, Kaçaniku; 9 mbledhje Obiliqi; 8 mbledhje ka mbajtur Podujeva dhe Novobërda, kurse Kuvendi i Komunës së Shtërpcës ka mbajtur vetëm dy mbledhje.

Në Komunën e Novobërdës problemet janë paraqitur si pasojë e bojkotimit të punës së Kuvendit nga ana e anëtarëve të Kuvendit që i përkasin komunitetit

serb. Pavarësisht kësaj, kuvendi i Komunës ka vazhduar mbajtjen e mbledhjeve edhe pa praninë e tyre.

Gjithashtu, edhe në Komunën e Shtërpcës, puna e Kuvendit Komunal dhe administratës komunale në përgjithësi është totalisht e bllokuar për shkak të bojkotit të punëtorëve serbë që punojnë në administratën komunale.

Për shkak të mungesës së të dhënave nga komunat e veriut, ku komuniteti serb është shumicë (komuna që nuk i janë përgjigjur pyetësorëve të hartuar nga MAPL), raporti nuk përmban aktivitetet e kuvendeve të këtyre komunave.

(shih tabelën nr 1, ku pasqyrohet numri i mbledhjeve të Kuvendeve Komunale për secilën Komunë të Republikës së Kosovës. Tabela nr.1 pasqyron numrin e mbledhjeve të mbajtura në vitin 2008 dhe tabela nr.2 paraqet krahasimin ndërmjet numrit të mbledhjeve në gjashtëmujorin e parë dhe gjashtëmujorin e dytë të vitit 2008)


Numri i mbledhjeve të rregullta të
Kuvendeve të Komunave për periudhën janar-dhjetor 2008
Gjakova, Vitia, Kamenica, Fushë Kosova, Dragashi, Skenderaj, Hani i Elezit, Gllogoci, Juniku, Istogu, Klina, Kacaniku
10
Obiliqi
9
Podujeva, Novobwrda,
8
Shtërpca
2
Ferizaj, Malishevë, Prizren
7
Mitrovicë
14
Deçani, Shimja, Lipjani, Prizreni, Prishtina, Mamusha
12
Malisheva, Suhareka, Gjilani, Rahoveci, Ferizaj, Peja, Vushtrria
11
Ferizaj, Malishevë, Prizren
Mitrovicë
Decani, Shimja, Lipjani, Prizreni, Prishtina, Mamusha
Malisheva, Suhareka, Gjilani, Rahoveci, Ferizaj, Peja, Vushtrria
Gjakova, Vitia, Kamenica, Fushë Kosova, Dragashi, Skenderaj, Hani i Elezit, Gllogoci, Juniku, Istogu, Klina, Kaçaniku
Obiliqi

Fig. 1

Fig.2


Krahasimi i numrit të mbledhjeve të Kuvendeve Komunale për gjashtëmujorin e parë 2008 dhe gjashtëmujorin e dytë 2008
Deçani
Dragash
F.Kosovë
Ferizaj
Gjakovë
Gjilan
Gllogoc
PNJK Hani I Elezit
Istog
PNJK Junik
Kaçanik
Kamenicë
Klinë
Lipjan
Malishevë
PNJK Mamushë
Mitrovicë
Novobërdë
Obiliq
Pejë
Podujevë
Prishtinë
Prizren
Rahovec
Shtërpcë
Shtime
Skenderaj
Suharekë
Viti
Vushtrri
Mbledhjet e Kuvendeve Komunale për Gjashtë mujorin e dytë 2008
Mbledhjet e Kuvendeve Komunale për gjashtëmujorin e parë 2008

Konkluzion:

Nga të dhënat që ka në dispozicion MAPL, mund të përfundojmë se shumica e Komunave janë përafërsisht brenda dinamikës së paraparë për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendeve Komunale, në përputhje me nenin 15 të rreg. 2007/30, dhe në përputhje me nenin 43.2 të Ligjit për vetëqeverisje lokale.

Nga të gjitha Komunat e Republikës së Kosovës vetëm 4 Komuna (Novobërdë, Obiliq, Podujevë dhe Shtërpcë) kanë mbajtur më pak mbledhje se sa është paraparë sipas legjislacionit në fuqi. 12 Komuna kanë mbajtur më shumë mbledhje gjatë gjashtëmujorit të dytë se sa gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2008; 10 komuna kanë mbajtur numër të njëjtë mbledhjesh për të dy pjesët e vitit (gjashtëmujorët); ndërsa 8 komuna kanë mbajtur më pak mbledhje gjatë gjashtëmujorit të dytë, sesa gjatë gjashtëmujorit të parë. Sipas evidentimit të gjendjes në Komuna është e qartë se komunat gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2008 kanë mbajtur më shumë mbledhje se sa në gjashtëmujorin e parë të vitit 2008.

Zgjedhja e kryesuesve

Sfondi ligjor - Sipas nenit 11 të rreg. 2007/30, Kuvendi Komunal bënte zgjedhjen e zëvendëskryesuesit të kuvendit komunal. Kuvendet komunale duhej të zgjidhnin nga përbërja e Kuvendit Komunal zëvendëskryesuesin, i cili në mungesë të Kryetarit të Komunës, kryesonte mbledhjet e Kuvendit Komunal.

Rregullorja parashihte që në komunat ku jetojnë komunitete të cilët nuk janë shumicë, kuvendi komunal zgjidhte një zëvendës-kryesues të dytë nga këshilltarët e kuvendit komunal.
Nëse këto komunitete nuk kishin anëtarë në kuvendin komunal, kuvendi komunal caktonte një person nga këto komunitete, në konsultim të drejtpërdrejtë me pjesëtarët e tyre, për të shërbyer si zëvendëskryesues me të drejtë pjesëmarrjeje dhe këshillimore, por pa të drejtë vote në mbledhjet e kuvendit komunal dhe në komitetet e tij.

Me LVL është paraparë edhe pozita e re e kryesuesit të Kuvendit të Komunës, për dallim me Rregulloren 2007/30, ku Kryetari i Komunës ishte edhe kryesues i Kuvendit të Komunës. Sipas nenit 41 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Kuvendi Komunal bën zgjedhjen e kryesuesit të kuvendit te Komunës nga përbërja e anëtarëve të Kuvendit Komunal, ndërsa zëvendës kryesues kanë vetëm komunat që kanë 10% minoritete.

Vlerësimi i gjendjes aktuale. - Komunat e Gjilanit, Skenderajt, Rahovecit, Hanit të Elezit, Gllogocit, Junikut, Mamushës, Ferizajt, Istogut, Klina, Kaçaniku, Peja,

Vushtrrisë, Podujevës, Mitrovicës, Gjakovës, Suharekës, Malishevës, Lipjanit, Prizrenit, Shtimes, Vitisë, Kamenicës, Deçanit, Fushë Kosovës dhe Dragashit kanë zgjedhur kryesuesin e kuvendit komunal.
Ndërsa komunat e Obiliqit, Prishtinës, Novobërdës dhe Shtërpcës nuk e kanë zgjedhur kryesuesin e Kuvendit Komunal.

Zgjedhja e zëvendës kryesuesit për komunitete

Sfondi Ligjor. - Sipas LVL është paraparë edhe pozita e zv. Kryesuesit të Kuvendit të Komunës për Komunitete, duke përcaktuar kriterin e popullsisë, ku së paku 10% e qytetarëve i takojnë komuniteteve joshumicë. Posti i zëvendëskryesuesit të kuvendit të komunës për komunitete rezervohet për përfaqësuesin e këtyre komuniteteve. Kandidati përfaqësues i popullatës jo-shumicë, që ka marrë më shumë vota në listën e hapur të kandidatëve për zgjedhje në Kuvendin e Komunës, caktohet në detyrën e zv. Kryesuesit. (Ndërsa Rregullorja 2007/30 parashihte që në komuna ku jetojnë një apo më shumë komunitete jo shumicë, kuvendi komunal zgjidhte një zëvendëskryesues të dytë nga këshilltarët e kuvendit komunal nga këto komunitete, sipas një procedure të përcaktuar në Statutin e komunës. Nëse këto komunitete nuk kishin këshilltar në kuvendin komunal, kuvendi caktonte një person nga këto komunitete, në konsultim me pjesëtarët e tyre, për të shërbyer si zëvendëskryesues me të drejtë që të merrte pjesë dhe të fliste si këshilltar, pa të drejtë vote në mbledhjet e kuvendit komunal dhe në komitetet e tij).

Vlerësimi i gjendjes aktuale. - Zëvendëskryesuesi i kuvendit të komunës për komunitete është zgjedhur në këto komuna: Gjakovë, Prizren, Fushë Kosovë, Dragash, Prishtinë, Ferizaj, Istog, Pejë.
Komunat e Suharekës, Mitrovicës, Malishevës, Deçanit, Podujevës, Shtimes dhe Vushtrrisë nuk kanë zgjedhur Zv.kryesues për komunitete, sepse në këto Komuna përqindja e komuniteteve nuk arrin në 10%, sa është parashikuar me me LVL-në.

Konkluzion:

MAPL, në bazë të raporteve të monitorimit, konstaton se komunat kanë ndjekur procedurat sipas legjislacionit në fuqi në lidhje me zgjedhjen e Kryesuesve dhe zv. Kryesuesve të Komunave.

Funksionimi i komiteteve të Kuvendeve të Komunave

Sfondi ligjor - Sipas nenit 21 të rreg. 2007/30 Kuvendi komunal krijonte si komitete të përhershme Komitetin për politikë dhe financa, Komitetin për komunitete dhe Komitetin për ndërmjetësim. Ndërsa, Kuvendi komunal mund

të themelonte edhe komitete të tjera si komitete të përhershme sikurse Komitetin për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, Komitetin për arsim dhe kulturë, Komitetin për Zhvillim ekonomik, Komitetin për planifikim urban, kadastër dhe mbrojtjen e ambientit, apo mund të krijonte edhe komitete të tjera dhe të vendoste për kompetencat dhe veprimtaritë e tyre.

Sipas nenit 51.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Kuvendet e komunave themelojnë si komitete të përhershme Komitetin për politikë dhe financa dhe Komitetin për komunitete. Mirëpo me LVL, Kuvendit të Komunës i lihet në përgjegjësi për të themeluar komitete të tjera për të cilat konsideron se janë të nevojshme për kryerjen e përgjegjësive të tij

Vlerësimi i gjendjes aktuale në Komuna –

Komiteti për politikë dhe financa

Komiteti për politikë dhe financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik të komunës. Ky komitet ka mbajtur mbledhje varësisht angazhimit në komuna, sipas kësaj radhe: 12 mbledhje Komuna e Shtimes, Pejës, Rahovecit, 11 mbledhje në Vushtrri, Mitrovicë, Hani i Elezit dhe Lipjan, 10 mbledhje në Malishevë, Deçan, Klinë, Istog, Ferizaj, Gjilani, Skenderaj, Kamenicë, 9 mbledhje ka mbajtur në Suharekë, Juniku, Prishtina, dhe Prizren; 8 mbledhje ka mbajtur në Podujevë, Mamushë, Obiliq, Gllogoc; 7 mbledhje në Dragash, Kaçanik, dhe Gjakovë; 6 mbledhje janë mbajtur në Viti dhe Fushë Kosovë, dhe 5 mbledhje ka mbajtur KPF në Novobërdë. Në Shtërpcë ky komitet nuk është themeluar.

Komiteti për Komunitete

Komiteti për komunitete është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, për t'u siguruar se të drejtat e komuniteteve respektohen plotësisht.
Komiteti për komunitete ka mbajtur: 11 mbledhje në Deçan, 10 mbledhje në Prizren; 9 mbledhje në Gjilan; 8 mbledhje në Gjakovë; 7 mbledhje në Pejë; 6 mbledhje në Vushtrri dhe Suharekë, nga 5 mbledhje në Podujevë, Mamushë dhe Lipjan; 4 mbledhje në Dragash, Han të Elezit, Istog dhe Shtime, 3 mbledhje në Malishevë, Skenderaj dhe Mitrovicë, 2 mbledhje në Fushë Kosovë, Ferizaj, Obiliq, 1 mbledhje Kamenica, Kaçaniku, Rahoveci, dhe asnjë mbledhje në Viti.

Komunat e Prishtinës, Junikut, Novobërdës dhe Klinës nuk e kanë paraqitur numrin e mbledhjeve të komitetit për komunitete. Ndërsa ky komitet nuk është themeluar në Shtërpcë dhe Gllogoc.

Komitetet e tjera

Kuvendet e komunave, përveç komiteteve obligative (komitetit për politikë dhe financa dhe komitetit për komunitete), themelojnë edhe komitetet e tjera, varësisht nga nevoja dhe vlerësimi i kuvendit. Komitetet e tjera, të cilat pothuajse janë themeluar në të gjitha Komunat janë: Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, Komiteti për Shërbime Publike, Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Komiteti për Zhvillim Ekonomik, Komiteti për Barazi Gjinore etj.

Në vijim është paraqitur numri i komiteteve të tjera që janë themeluar në komuna: Prizren (9), Prishtinë (8), Gjilan (7), Malishevë, Podujevë, Rahovec dhe Mitrovicë (6), Deçan dhe Kamenicë (5), Obiliq, Ferizaj, Klina, Kaçaniku (4), Lipjan, Skenderaj, Pejë (3), Mamushë (2) dhe në Suharekë, Fushë Kosovë dhe Shtime (1).

Ndërsa në Komunën e Dragashit, Shtërpcës, Hanit të Elezit, Drenasit, Junikut, Novobërdës, Istogut dhe Vitisë nuk janë themeluar Komitete të tjera. Edhe komuna e Vushtrrisë në kohën e raportimit ka qenë në fazën e themelimit të komiteteve.


Numri i mbledhjeve të komiteteve obligative për vitin 2008
Deçani
Dragash
F.Kosovë
Ferizaj
Gjakovë
Gjilan
Gllogoc
hani I Elezit
Istog
Junik
Kaçanik
Kamenicë
Klinë
Lipjan
Malishevë
Mamushë
Mitrovicë
Novobërdë
Obiliq
Pejë
Podujevë
Prishtinë
Prizren
Rahovec
Shtërpcë
Shtime
Skenderaj
Suharekë
Viti
Vushtrri
KPF (komiteti për politikë dhe financa
KK (komiteti për komunitete)

fig.3

Konkluzion:

Nga të dhënat që ka në dispozicion MAPL, komitetet obligative janë formuar gati në të gjitha komunat. Përjashtim bën komuna e Shtërpcës, e cila nuk e ka formuar komitetin për politikë dhe financa dhe Komitetin për komunitete.Gjithashtu, edhe komuna e Gllogocit nuk ka themeluar komitetin për komunitete. Aktivitet më dinamik ka pasur Komiteti për Politikë dhe Financa për dallim nga komitetet e tjera.

Tubimet Publike

Sfondi Ligjor - Sipas nenit 8 të rregullores së UNMIK-ut 2007/30 Komunat kanë qenë të obliguara të organizojnë tubime publike periodike, së paku dy herë në vit, në të cilat mund të merrnin pjesë të gjithë njerëzit apo subjektet e interesuara për komunën. Nuk ka ndonjë ndryshim esencial sa i përket tubimeve publike edhe në LVL. Sipas nenit 68.1 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, komunat duhet të organizojnë tubime publike periodike, së paku dy herë në vit, në të cilat mund të marrin pjesë të gjithë njerëzit apo subjektet e interesuara për komunën.

Vlerësimi i gjendjes aktuale në Komuna - Komuna e Prizrenit ka mbajtur 8 tubime publike, Prishtina 7 tubime, Kamenica 6 tubime, Hani i Elezit dhe Klina kanë mbajtur nga 4 tubime, Podujeva, Rahoveci, Obiliqi dhe Gjakova nga 3 tubime, komuna e Vushtrrisë, Mitrovicës, Suharekës, Gjilanit, Skenderajt, Gllogocit, Junikut, Ferizajt, Novobërdës, Istogut, Kaçanikut, Pejës, Malishevës, Lipjanit, Shtimes, Vitisë, Deçanit, Fushë Kosovës dhe Dragashit kanë mbajtur nga dy tubime publike, kurse Shtërpca nuk ka mbajtur asnjë tubim publik.

Konkluzion:

Sipas evidentimit të gjendjes në terren, mund të konkludohet se të gjitha Komunat me përjashtim të Shtërpces kanë përmbushur obligimin ligjor në lidhje me mbajtjen e tubimeve publike. Madje, një numër i konsiderueshëm i komunave kanë mbajtur numër më të madh se sa është paraparë sipas ligjit.

Kërkesat e qytetarëve për qasje në dokumentet zyrtare

Sfondi Ligjor. - Ligji për qasje në dokumente zyrtare i garanton qytetarëve të drejtën për qasje në dokumentet zyrtare të institucioneve.
Vlerësimi i gjendjes aktuale – Në shumë Komuna nuk ka pasur fare kërkesa për qasje në dokumentet zyrtare. Në lidhje me këtë, në vijim paraqesim numrin e kërkesave për qasje në dokumente në komunat që kanë pranuar këtë kategori të kërkesave: 95 kërkesa ka pasur Komuna e Kaçanikut; Klina 16; Prishtina 9; komunat e Mitrovicës, Suharekës dhe Prizrenit kanë pasur nga 7 kërkesa; 5

kërkesa ka pasur komuna e Kamenicës; Gjilani dhe Peja nga 3 kërkesa; Ferizaj 2 kërkesa, 1 kërkesë ka pasur Komuna e Vitisë, Shtërpcës, Skenderajt dhe e Lipjanit; ndërsa 1 kërkesë tjetër nga një OJQ ka pasur komuna e Gjakovës.

Komunat e tjera nuk kanë pasur kërkesa për qasje në dokumentet zyrtare.

Peticionet e qytetarëve drejtuar komunës

Sfondi ligjor: Sipas LVL neni 69 çdo person, organizatë me interes në komunë ka të drejtën që t'i drejtohet kuvendit të komunës me peticion për çfarëdo çështje lidhur me përgjegjësitë dhe kompetencat e komunës.

Kuvendit të Komunës së Gjakovës, Gllogocit, Vushtrrisë, Gjilanit, Dragashit, Lipjanit i është paraqitur nga një 1 kërkesë. Kuvendit Komunal të Obiliqit i janë drejtuar 4 peticione të cilat janë shqyrtuar. Suharekës i është paraqitur 1 kërkesë dhe një peticion, i cili është aprovuar nga kuvendi i komunës. Në Fushë Kosovë dhe Pejë janë paraqitur 2 peticione, të cilat janë shqyrtuar. Shtimes i është paraqitur një peticion, i cili gjithashtu është shqyrtuar. Kurse në Komunën e Prizrenit, Malishevës, Deçanit, Podujevës, Shtërpcës, Hanit të Elezit, Prishtinës, Junikut, Ferizajt, Novobërdës, Mamushës, Istogut, Klinës, Skënderajt, Rahovecit, Kaçanikut dhe Vitisë nuk ka pasur peticione të paraqitura.

Aktet juridike të Komunës

Sfondi ligjor - Sipas nenit 11 të rregullores 2007/30, Kuvendi i Komunës miraton Statutin dhe e ndryshon atë, nëse konsideron se një gjë e tillë është e nevojshme. Edhe sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, neni 12, Kuvendi i Komunës miraton Statutin dhe e ndryshon atë nëse konsideron se një gjë e tillë është e nevojshme.

Vlerësimi i gjendjes aktuale në Komuna - Pas miratimit të Rregullores 2007/30 për ndryshimin e Rregullores 2000/45 për vetëqeverisjen e komunave lindi nevoja për ndryshimin e statuteve komunale, të cilat ishin në fuqi sipas rregullores së UNMIK-ut 2000/45.
Në gjashtëmujorin e parë, sipas rregullores 2007/30, kanë miratuar statutet komunat si vijon: Deçan, Fushë Kosovë, Mitrovicë, Vushtrri, Istog, Suharekë, Gllogoc, Novobërdë, Prishtinë, Kaçanik, Shtime, Gjakovë, Gjilan, Skenderaj, Dragash, Klinë, Kamenicë. Ndërsa rregulloren e punës e kanë miratuar këto komuna: Deçan, Fushë Kosovë, Mitrovicë, Pejë, Istog, Gllogoc, Gjakovë, Gjilan, Kamenicë, Rahovec.

Pas miratimit të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale është paraqitur nevoja për ndryshimin e statuteve komunale aktuale.

Në shumicën e komunave janë formuar komisionet për ndryshimin dhe hartimin e statuteve në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Deri në fazën e raportimit, statutet janë miratuar në këto komuna: Dragash, Fushë Kosovë, Deçan, Kamenicë, Viti, Shtime, Prizren (i kthyer për ri-shqyrtim nga MAPL), Lipjan, Malishevë, Suharekë, Gjakovë, Mitrovicë, Vushtrri, Gjilan, Skenderaj, Rahovec, Obiliq, Hani i Elezit, Gllogoc, Junik, Ferizaj, Novobërdë, Mamushë, Istog, Klinë, Kaçaniku, Pejë.
Komunat e Podujevës, Prishtinës dhe Shtërpcës nuk e kanë miratuar statutin**.**

Përveç statutit, komunat kanë miratuar edhe rregullore nga fushë veprimtaria e komunës, në bazë të përgjegjësive dhe kompetencave që iu takojnë, si dhe në bazë të nevojës për harmonizimin me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Gjatë vitit 2008 komunat kanë miratuar këtë numër të rregulloreve:

Deçani ka miratuar 5 Rregullore, Dragashi 4, Kamenica 4, Vitia 4, Mitrovica 4, Suhareka 4, Fushë Kosova 3 Shtime, Lipjani 3, Gjakova 3 Prizreni 3, Malisheva 2, Vushtrria 2, Peja 7, Gjilani 6, Skenderaj 5, Novobërda 4, Prishtina, Juniku, Istogu, Klina 3, Obiliqi, Rahoveci, Gllogoci, Ferizaj, Mamusha, Kaçaniku 2, Hani i Elezit 1, Podujeva dhe Shtërpca nuk ka miratuar asnjë Rregullore.

Rregullorja Komunale për Gjuhët

Rregullore komunale për gjuhët kanë këto komuna: Suhareka, Fushë Kosova , Obiliqi, Novobërda, Mamusha, Klina, Peja dhe Prizreni. Komunat e tjera nuk e kanë miratuar ende këtë rregullore.

Konkluzion:

Një numër i konsiderueshëm i Komunave kanë miratuar statutet e tyre dhe i kanë harmonizuar me LVL. MAPL ka përkrahur në vazhdimësi komunat në lidhje me miratimin e statuteve, duke pasur parasysh se komunave iu është dashur që brenda një viti të ndryshojnë statutet e tyre dy herë, për shkak të ndryshimeve në legjislacionin që prek kompetencat e Komunave.

Drejtoritë Komunale

Sfondi Ligjor - Sipas nenit 29 të Rregullores 2007/30 për ndryshimin e Rregullores 2000/45 për vetëqeverisjen e komunave, përcaktohen drejtoritë bazike (Drejtoria për Administratë dhe Personel, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale,

Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës, Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrës dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Zyra Komunale për Komunitete), si dhe drejtoritë e tjera që konsiderohen të nevojshme për ushtrimin e funksioneve dhe përgjegjësive të komunës.
Kryetarët e Komunave, në konsultim me Kuvendin Komunal, kishin të drejtën e emërimit të drejtorëve të drejtorive komunale.

Sipas LVL, administrata komunale organizohet në drejtorate (që nënkupton se nuk kufizohet numri i drejtorateve komunale). Çdo drejtorat komunal menaxhohet nga drejtori, i cili emërohet dhe shkarkohet nga kryetari. (Nuk ka shefa të drejtorateve nga pjesa e stafit civil, që ekzistonin sipas 2007/30). Me LVL është lënë në kompetencë të komunës të vendosë për numrin e drejtorive komunale dhe organizimin e brendshëm.

Vlerësimi i gjendjes aktuale në Komuna - Numri i drejtorive në komuna është si vijon: 12 drejtori Vushtrria; 11 drejtori Prizreni; 10 drejtori Fushë Kosova, Lipjani, Mitrovica, Gjakova, Ferizaj, Gllogoci; 9 drejtori Deçani, Suhareka, Rahoveci, Peja; 8 drejtori Vitia, Malisheva, Dragashi, Obiliqi, Prishtina, Istogu, Klina; 7 drejtori Kaçaniku, Novobërda, Skenderaj; 6 drejtori Kamenica, Shtimja, Shtërpca, Hani i Elezit, Juniku; 5 drejtori Podujeva; 4 drejtori Mamusha.

Konkluzion:

Një numër i konsiderueshëm i Komunave nuk i kishin respektuar dispozitat e rregullores 2007/30 në lidhje me numrin e drejtorive komunale. Ndërsa me hyrjen në fuqi të LVL, duke pasur parasysh se nuk kishte kufizime në këtë drejtim, këto probleme janë evituar, meqë është në kompetencë të komunës që sipas nevojave specifike të caktojë edhe numrin e drejtorive.

Raportimi i Kryetarit të Komunës para Kuvendit Komunal

Sfondi Ligjor - Me nenin 27.7 të Rregullores 2007/30 për ndryshimin e Rregullores 2000/45 për vetëqeverisjen e komunave, Kryetari i komunës i raportonte kuvendit komunal të paktën çdo tre muaj. Ndërsa sipas LVL, neni 58 (pika j.), Kryetari i komunës raporton para kuvendit të komunës për situatën ekomomike financiare të komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të komunës, së paku njëherë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga kuvendi i komunës.

Vlerësimi i gjendjes aktuale në Komuna - Kryetari i komunës së Skenderajt ka raportuar 4 herë para kuvendit, nga 3 herë kanë raportuar kryetari i komunë së Gjakovës, Lipjanit, Gjilanit dhe Fushë Kosovës, 2 herë ka raportuar kryetari i

komunës së Vushtrrisë, Podujevës, Rahovecit, Obiliqit, Prishtinës, Gllogocit, Junikut, Ferizajt, Novobërdës, Mamushës, Istogut, Klinës, Kaçanikut, Mitrovicës, Suharekës, Malishevës, Prizrenit, Kamenicës, Deçanit, 1 herë ka raportuar kryetari i komunë së Vitisë, Pejës dhe Dragashit. Kryetarët e komunave të Shtimes, Hanit të Elezit dhe Shtërpcës nuk kanë raportuar asnjëherë.

Konkluzion:

Në të gjitha komunat raportimi i Kryetarit është bërë në formë të informatës me shkrim.

Regjistri i pronës komunale

Komunat mbajnë dhe udhëheqin regjistrin e pronës së luajtshme dhe të paluajtshme.
Regjistër të plotë të pronës së luajtshme dhe të paluajtshme kanë këto komuna: Dragashi, Deçani, Kamenica, Shtimja, Prizreni, Malisheva, Prishtina, Ferizaj, Istogu, Klina, Peja, dhe Podujeva. Komunat e Fushë Kosovës, Vitisë, Lipjanit, Suharekës, Gjakovës, Gjilanit, Rahovecit, Mamushës, Gllogocit, Kaçanikut dhe Mitrovicës janë në përpilim e sipër të këtyre regjistrave, ku komisionet e posaçme po punojnë në këtë drejtim. Për komunën e Vushtrrisë nuk kemi të dhëna. Komunat e Shtërpcës, Skenderajt, Obiliqit, Hanit të Elezit, Junikut dhe Novobërdës nuk kanë regjistër të pronës së luajtshme.

Auditori i brendshëm në komuna

Kryesisht të gjitha Komunat kanë auditorët e brendshëm. Komunat Prizren, Lipjan, Gjilan, Istog, Pejë, Skenderaj dhe Viti i kanë publikuar raportet e auditimit edhe në faqet zyrtare të internetit. Në komunën e Fushë Kosovës, Prishtinës dhe të Kamenicës auditorët i raportojnë Kuvendit. Komunat e Junikut, Obiliqit dhe Shtërpcës nuk kanë auditor të brendshëm.

Funksionimi i faqeve zyrtare të internetit në Komuna

Rol të rëndësishëm në transparencën e komunës luan edhe faqja e saj zyrtare e internetit, në të cilën publikohen në mënyrë elektronike aktivitetet kryesore të komunës.

Në bazë të dhënave nga komunat është vërejtur se në këtë periudhë (janar – dhjetor) ka përmirësim të funksionimit të faqeve në krahasim me periudhat e mëhershme.
Përveç komunave të Fushë Kosovës, Shtërpcës, Hanit të Elezit, Novobërdës Mamushës dhe Dragashit, të cilat nuk i kanë funksionale faqet e internetit, në të

gjitha komunat e tjera këto faqe funksionojnë. Raporti i detajuar i funksionimit të faqeve zyrtare të Komunave të Republikës së Kosovës gjendet në faqen zyrtare të internetit të MAPL-së (www.ks-gov.net/mapl/).

Ndërmarrjet Publike Komunale

Sipas Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike, menaxhimi i ndërmarrjeve publike komunale është në kompetencë të Komunave. Me këtë ligj parashihet që ndërmarrjet publike që ofrojnë shërbime për më pak se 3 (tri) komuna, do të jenë ndermarrje publike lokale. Nëse ndërmarrja publike ofron shërbime për më shumë se një komunë, përqindja e pronësisë së secilës komunë, do të jetë e barabartë me përqindjen e klientëve të regjistruar të kësaj ndërmarrje publike lokale në atë komunë.
Zbatimi i këtij ligji ka hasur në vështirësi për arsye të koorporatizimit të ndërmarrjeve publike dhe tani është vështirë të përcaktohet se kush dhe sa janë aksionet e komunës në një ndërmarrje pas korporatizimit.
Në vijim po paraqesim të dhënat që na kanë ofruar komunat, sa i përket ndërmarrjeve publike që operojnë në territorin e tyre:

Vushtrria ka 1 ndërmarrje publike, baza e së cilës ndodhet në Mitrovicë; në Kamenicë ekzistojnë 2 njësi punuese (Higjiena, Hidromorava); Shtimja 2 ndërmarrje (NP Prishtina dhe Pastërtia); Vitia 1 ndërmarrje (Univerzal); Mitrovica 3 (Uniteti, Ujësjellësi regjional dhe Kosova Trans); Suhareka 3 (Komunalja, Hidroregjioni jugor i ujësjellësit dhe stacioni i autobusëve); Podujeva 4 ndërmarrje; Deçani 2 (Ujësjellësi dhe Higjiena); Malisheva 2 (NP "Lumi" dhe NP "Syri i Kaltër"); Gjakova 2 ndërmarrje (Çabrati dhe ngrohtorja e qytetit); Prizreni 2 ndërmarrje publike (Hidroregjioni dhe Ekoregjioni), ndërsa Fushë Kosova, Dragashi dhe Lipjani nuk kanë ofruar të dhëna në lidhje me këtë.
Në komunën e Shtërpcës ka Ndërmarrje publike, por që nuk janë të regjistruara dhe që nuk menaxhohen nga institucionet e Kosovës.
Komuna e Gjilanit ka 4 Ndërmarrje publike, Prishtina 6, Istogu 3, Klina, Skenderaj, Rahoveci, Drenasi, Ferizaj, Kaçaniku nga 2 Ndërmarrje, Peja 1 .

Komunat Obiliq, Hani i Elezit, Mamushë, Junik dhe Novobërdë nuk kanë Ndërmarrje Publike komunale.

Plani për administrimin e mbeturinave

Ligji për mbeturina obligon Komunat që të përgatisin planin lokal për menaxhimin e mbeturinave. Komunat duhet të përgatisin plane për periudhën 5 vjeçare brenda një viti nga hartimi i planit të Kosovës. Sa i përket menaxhimit të

mbeturinave, gjendja në komunat e Kosovës është paraqitur si vijon: Fushë Kosova, Prizreni, Gjakova, Dragashi, Lipjani, Suhareka, Mitrovica, Gjilani, Prishtina, Gllogoci, Ferizaji dhe Vitia kanë planin për administrimin e mbeturinave, ndërsa komunat e Malishevës, Deçanit, Podujevës, Shtimes, Kamenicës, Shtërpcës, Rahovecit, Hanit të Elezit, Junikut, Novobërdës, Obiliqit, Mamushës, Istogut, Klinës, Pejës dhe e Vushtrrisë nuk e kanë planin për administrimin e mbeturinave**.** Në Skenderaj ekziston rregullorja e viteve të kaluara.

Gjendja me Planin zhvillimor komunal dhe planin zhvillimor urban

Kuvendet e Komunave janë përgjegjëse për miratimin e planit zhvillimor komunal, planit zhvillimor urban dhe planit rregullativ urban. Gjendja në komuna sa i përket miratimit të këtyre planeve është si vijon:

Kuvendet e Komunave të Kamenicës, Gjakovës, Suharekës, Gjilanit, Junikut, Klinës, Pejës dhe Lipjanit kanë miratuar ***planin zhvillimor komunal*** dhe ***planin zhvillimor urban***.

Kuvendet e Komunave të Skenderajt, Rahovecit, Obiliqit, Hanit të Elezit, Gllogocit, Ferizajt, Novobërdës, Mamushës, Istogut, Kaçanikut ***nuk kanë miratuar Planin zhvillimor urban dhe atë komunal***.

Kuvendi i Komunës së Deçanit e ka miratuar, por pritet pëlqimi i MMPH;
Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë është në fazën e diskutimit në kuvend;
Kuvendi i Komunës së Vitisë në fazën e fillimit të punimeve;
Kuvendi i Komunës së Mitrovicës në fazën e diskutimit publik;
Kuvendi i Komunës së Shtimes në fazën e zgjedhjes së këshillit të ekspertëve;
Kuvendi i Komunës së Prishtinës planin zhvillimor urban e ka miratuar, kurse plani zhvillimor komunal është në miratim e sipër;
Kuvendi i Komunës së Shtërpcës i ka miratuar, por pritet pëlqimi i Ministrisë;

Ndërsa Kuvendet e Komunave të Malishevës, Podujevës, Dragashit dhe Fushë Kosovës nuk i kanë miratuar këto plane.

Tabela e veprimeve të Komunave për implementimin e Ligjit për vetëqeverisje lokale dhe obligimet e tyre në gjashtëmujorin e parë pas hyrjes në fuqi të LVL

Komuna	Statuti	Kryesuesi	Zv.Kryesuesi për Komunitete	Nënkryetari i Komunës	Nënkryetari i Komunës për Komunitete
Fushë Kosovë	Po	Po	Po	Po	Jo
Ferizaj	Po	Po	Po	Po	Jo
Gjilan	Po	Po	Jo	Po	Po
Gllogoc	Po	Po	Jo	Po	Jo
Istog	Po	Po	Po	Po	Jo
Kaçanik	Po	Po	Jo	Po	Jo
Kamenicë	Po	Po	Jo	Po	Po
Klinë	Po	Po	Jo	Po	Jo
Lipjan	Po	Po	Jo	Po	Po
Malishevë	Po	Po	Jo	Po	Jo
Pejë	Po	Po	Po	Po	Po
Rahovec	Po	Po	Jo	Po	Po
Viti	Po	Po	Jo	Po	Po
Shtime	Po	Po	Jo	Po	Jo
Mitrovicë	Po	Po	Jo	Po	Jo
Skenderaj	Po	Po	Jo	Po	Jo
Deçan	Po	Po	Jo	Po	Jo
Gjakovë	Po	Po	Po	Po	Jo
Vushtrri	Po	Po	Jo	Po	Jo
Junik	Po	Po	Jo	Po	Jo
Suharekë	Po	Po	Jo	Po	Jo
***Prizren**	MAPL e ka kthyer në rishqyrtim	Po	Po	Po	Po
***Mamushë**	MAPL e ka kthyer në rishqyrtim	Po	Jo	Jo	Po
Dragash	Po	Po	Po	Jo	Jo
Hani Elezit	Po	Po	Jo	Jo	Jo
Obiliqi	Po	Jo	Jo	Po	Po
Podujeva	Jo	Po	Jo	Jo	Jo
Shtërpca	Jo	Po	Jo	Jo	Po
Novobërda	Po	Jo	Jo	Jo	Po
Prishtina	Jo	Jo	Po	Jo	Jo
Zubin Potoku	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo
Zveçan	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo
Leposaviq	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo

Konkluzion:

- *27 Komuna kanë miratuar Statutin (prej të cilave 2 janë kthyer në rishqyrtim);*
- *25 Komuna kanë zgjedhur Kryesuesin;*
- *24 Komuna kanë emëruar Nënkryetarin;*
- *6 Komuna nuk i kanë miratuar Statutet;*
- *7 Komuna nuk e kanë zgjedhur Kryesuesin ;dhe*
- *9 Komuna nuk e kanë zgjedhur nënkryetarin.*

Informimi i MAPL-së për mbajtjen e seancave të Kuvendeve të Komunave

Sfondi ligjor: Ligji për Vetëqeverisje Lokale obligon Komunat e Republikës së Kosovës që të informojnë Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal në lidhje me mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit. Konkretisht dispozitat e nenit 43, paragrafët 3, 4 dhe 5, në lidhje me mbajtjen e mbledhjeve janë paraqitur si vijon:

43.3 Të gjithë anëtarët e kuvendit të komunës duhet të njoftohen paraprakisht me shkrim, ashtu siç kërkohet, shtatë (7) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes. Në njoftimin e tillë shkruhet:

a) data e mbajtjes së mbledhjes;
b) koha e mbajtjes së mbledhjes;
c) vendi i mbajtjes së mbledhjes;
d) rendi i ditës për mbledhje; dhe
e) materialet e mbledhjes.
f) të dhëna të tjera që mund të përcaktohen me Statut ose Rregullore të Punës.

43.4 Njoftimi dhe materialet e mbledhjes duhet të respektojnë Ligjin mbi Gjuhët. I njëjti njoftim duhet t'i shpallet publikut.

<u>43.5 Njoftimi nga paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni duhet gjithashtu t'i dërgohet ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale.</u>

Evidentimi i gjendjes aktuale: Pas hyrjes në fuqi të LVL-së, një numër i konsiderueshëm i komunave e respektojnë këtë dispozitë, mirëpo ka edhe Komuna të cilat nuk e informojnë MAPL-në në lidhje me mbajtjen e mbledhjeve. Situata paraqitet në tabelën si vijon:

Komunat që dërgojnë ftesa në MAPL	**Komunat që nuk dërgojnë ftesat**
Deçani	Dragashi
F.kosova	Vitia
Gjakova	Skenderaj
Gjilani	Prizreni
Gllogoci	Ferizaj
Istogu	Shtimja
Kaçaniku	
Kamenica	
Klina	
Lipjani	
Malisheva	
Novobërda	
Obiliqi	
Podujeva	
Prishtina	
Rahoveci	
Suhareka	
Vushtrria	
Peja	
Mitrovica	

Konkluzion:
Nga hyrja në fuqi e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, kryesisht Komunat e ftojnë rregullisht MAPL-së dhe 6 Komuna nuk e informojnë MAPL-në për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendeve të Komunave.

PJESA E DYTË

EFIKASITETI DHE AZHURITETI I ORGANEVE TË ADMINISTRATËS

Efikasiteti dhe azhuriteti i organeve administrative

Pjesa e dytë e këtij raporti paraqet analizën në lidhje me efikasitetin dhe azhuritetin e organeve komunale në procesin administrativ. Ky raport është vazhdimësi e raporteve paraprake, ndërsa analizimi i këtyre aktiviteteve ka filluar që nga viti 2006 në baza gjashtë mujore.
Qëllimi kryesor i vlerësimit të efikasitetit dhe azhuritetit është njohja me gjendjen reale të organeve të administratës komunale në shqyrtimin e lëndëve në procedurë administrative.

Raporti në vijim, do prezantojë të dhënat, të cilat kanë dërguar komunat në MAPL lidhur me efikasitetin dhe azhuritetin e organeve të 29 komunave. Në raport do të bëhet edhe krahasimi i gjendjes me periudhat paraprake, me qëllim që të krahasohet ngritja apo rënia e efikasitetit të punës së organeve të komunave në periudha të ndryshme dhe në ç'periudhë komunat kanë qenë më efikase.

Gjendja në Komuna për vitin 2008

Për vitin 2008 raportet i kanë dërguar 29 komuna. Në vijim do të prezantohet gjendja në komuna sipas drejtorive. Aneksi i këtij raporti pasqyron edhe gjendjen e lëndëve të shqyrtuara, të miratuara, refuzuara dhe të pezulluara në secilën komunë.

Komuna e Prishtinës

Për vitin 2008, komuna e Prishtinës ka dërguar raportin për tetë (8) drejtori. Numri i përgjithshëm i kërkesave, ne këto drejtori është 20137 kërkesa, prej të cilave janë shqyrtuar 17644 ose 87,61%.

Drejtoria për Administratë - janë pranuar 1891 kërkesa. Prej tyre janë shqyrtuar 1 511 kërkesa.
Drejtoria për Financa dhe Ekonomi dhe Zhvillim - janë pranuar gjithsej 7 708 kërkesa, të shqyrtuara gjithsej 6614 kërkesa.
Drejtoria për Planifikim Urban, Kadaster dhe Mbrojtje të Mjedisit - janë pranuar 5 767 kërkesa. Prej tyre 5414 janë të shqyrtuara.
Drejtoria për Arsim dhe Kulturë - janë pranuar 843 kërkesa, të shqyrtuara gjithsej 702 kërkesa.
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - janë pranuar 665 kërkesa. Prej tyre 598 kërkesa janë të shqyrtuara.

Drejtoria për Infrastrukturë Lokale - janë pranuar gjithsej 130 kërkesa. Prej tyre 113 janë të shqyrtuara.
Drejtoria për Pronë - janë pranuar 571 kërkesa, të shqyrtuara janë 433 kërkesa.
Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë Civile - ka patur gjithsej 2 562 kërkesa dhe ka shqyrtuar 2 259 kërkesa.

Komuna e Podujevës

Komuna e Podujevës ka dërguar raportin për pesë (5) drejtori. Numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori është 10 488 kërkesa, të shqyrtuara kemi 10 416 ose 99.31%.

Drejtoria për Administratë dhe Personel - janë pranuar 231 kërkesa. Prej tyre janë shqyrtuar 208 kërkesa.
Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim - janë pranuar gjithsej 232 kërkesa, të shqyrtuara janë 209 kërkesa.
Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit - janë pranuar 9 186 kërkesa. Prej tyre 9 160 janë të shqyrtuara.
Drejtoria për Arsim dhe Kulturë - janë pranuar 720 kërkesa. Të shqyrtuara janë të gjitha kërkesat.
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - janë pranuar 119 kërkesa, të shqyrtuara janë të gjitha kërkesat.

Komuna e Fushë Kosovës

Komuna e **Fushë Kosovës** ka dërguar raportin për tetë (8) drejtori. Numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori është 3 298 kërkesa, të shqyrtuara kemi 2 344 ose 71.07%. Prej tyre:

Drejtoria për Administratë - janë pranuar gjithsej 890 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim - janë pranuar 145 kërkesa, të shqyrtuara gjithsej 136 kërkesa.
Drejtoria për Planifikim Urban, Kadaster dhe Mbrojtje të Ambientit - janë pranuar gjithsej 784 kërkesa, të shqyrtuara janë 772 kërkesa.
Drejtoria për Rini dhe Sport - janë pranuar 3 kërkesa dhe të gjitha janë shqyrtuar.
Drejtoria për Bujqësi, Inspektorat dhe Zhvillim Rural - janë pranuar gjithsej 4 kërkesa, të gjitha janë shqyrtuar.
Drejtoria për Emergjencë dhe Shërbime Publike - janë pranuar gjithsej 94 kërkesa, prej tyre 91 kërkesa janë të shqyrtuara.

Drejtoria për Inspekcion - janë pranuar gjithsej 128 kërkesa, të gjitha të miratuara.
Drejtoria për Arsim dhe Kulturë- ka patur gjithsej 2 kërkesa të cilat janë të shqyrtuara.

Komuna e Obiliqit

Komuna e **Obiliqit** ka dërguar raportin për gjashtë (6) drejtori. Numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori është 1791 kërkesa, të shqyrtuara kemi 1496 ose 83.53%. Prej tyre:

Drejtoria për Administratë - janë pranuar gjithsej 690 kërkesa, prej tyre 485 janë të shqyrtuara.
Drejtoria për Financa Ekonomi dhe Zhvillim - janë pranuar 380 kërkesa, të shqyrtuara kemi gjithsej 350.
Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit - janë pranuar gjithsej 561 kërkesa. Prej tyre të shqyrtuara kemi 544 kërkesa.
Drejtoria për Arsim dhe Kulturë - janë pranuar gjithsej 120 kërkesa, të shqyrtuara 89 kërkesa.
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - janë pranuar 21 kërkesa. Prej tyre të shqyrtuara 20 kërkesa.
Drejtoria për Emergjencë dhe Shërbime Publike - ka patur gjithsej 11 kërkesa, prej tyre 8 të shqyrtuara.

Komuna e Gllogocit

Komuna e Gllogocit ka dërguar raportin për dhjetë (10) drejtori. Numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori është 8 961 kërkesa, të shqyrtuara kemi 8 569, ose 95.62%.

Drejtoria për Administratë – janë pranuar 1 525 kërkesa, të shqyrtuara janë 1 522 kërkesa.
Drejtoria për Buxhet dhe Financa - janë pranuar gjithsej 4 739, janë shqyrtuar të gjitha.
Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit - janë pranuar 106 kërkesa, shqyrtuar 90 prej tyre.
Drejtoria për Arsim - janë pranuar 108 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - janë pranuar 1 465 kërkesa, prej të cilave 1 325 të shqyrtuara.

Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport ka patur gjithsej 22 kërkesa, 18 janë miratuar , 2 janë refuzuar, ndërsa 2 janë pezulluar.
Drejtoria për Bujqësi Ekonomi dhe Zhvillim – janë pranuar 116 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës - ka pranuar gjithsej 170 kërkesa, të shqyrtuara 140 kërkesa
Drejtoria për Inspekcion - ka patur gjithsej 76 kërkesa, të gjitha janë shqyrtuar.
Drejtoria për Kadaster, Gjeodezi dhe Pronë - ka patur gjithsej 634 kërkesa, të shqyrtuara 431 prej tyre.

Komuna e Lipjanit

Komuna e Lipjanit ka dërguar raportin për dymbëdhjetë (12) drejtori. Numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori është 8 702 kërkesa, të shqyrtuara 8563 kërkesa ose 95%. Prej tyre:

Drejtoria për Administratë dhe Personel - janë pranuar 52 kërkesa, të shqyrtuara të gjitha kërkesat.
Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim: janë pranuar gjithsej 2 677 kërkesa, të shqyrtuara të gjitha.
Drejtoria për Planifikim, Urbanizëm, Kadaster dhe Mjedis - janë pranuar 2 523 kërkesa, të shqyrtuara 2 399 kërkesa.
Drejtoria për Arsim dhe Kulturë – janë pranuar 29 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - janë pranuar gjithsej 492 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Rini dhe Sport - ka patur gjithsej 21 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Ekonomi dhe Bujqësi - ka patur gjithsej 13 kërkesa, të gjitha janë shqyrtuar.
Drejtoria e Inspekcionit - ka patur gjithsej 108 kërkesa, të shqyrtuara të gjitha.
Drejtori për Emergjencë - ka patur gjithsej 38 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Shërbime Publike - ka patur gjithsej 200 kërkesa, prej tyre 185 kërkesa janë shqyrtuar.
Drejtoria e Prokurimit - ka patur gjithsej 2 356 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.

Komuna e Shtimes

Komuna e **Shtimes** ka dërguar raportin për gjashtë (6) drejtori. Numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori është 979 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara:

Drejtoria për Administratë dhe Personel - janë pranuar gjithsej 377, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Planifikim Hapësinor dhe Mjedis - janë pranuar gjithsej 432, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Ekonomi dhe Financa – janë pranuar gjithsej 44, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Arsim dhe Kulturë, Rini dhe Sport - janë pranuar 33, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Inspektorat: ka patur gjithsej 25 kërkesa dhe të gjitha janë shqyrtuar.
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Mbrojtje dhe Emergjencë - janë pranuar gjithsej 8 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.

Komuna e Gjilanit

Komuna e Gjilanit ka dërguar raportin për dymbëdhjetë (12) drejtori. Numri i përgjithshëm i kërkesave është 8046 kërkesa, kurse të shqyrtuara i kemi 7036 kërkesa ose 87.44%.

Drejtoria e Administratës dhe Personelit - ka patur gjithsej 279 kërkesa, të shqyrtuara 127 kërkesa.
Drejtoria për Buxhet Financa dhe Investime - ka patur gjithsej 327 kërkesa, të shqyrtuara 244 kërkesa.
Drejtoria për Ekonomi dhe Menagjment - ka patur gjithsej 456 kërkesa, të shqyrtuara 435 kërkesa.
Drejtoria për Urbanizëm Rindërtim dhe Ambient - ka patur gjithsej 510 kërkesa, të shqyrtuara 358 kërkesa
Drejtoria për Gjeodezi Kadaster, Pronë e Banim - ka patur gjithsej 4 724 kërkesa, të shqyrtuara 4 395 kërkesa.
Drejtoria për Shërbime Publike - ka patur 667 kërkesa, të shqyrtuara 595 kërkesa.
Drejtoria e Arsimit - ka patur gjithsej 90 kërkesa, të shqyrtuara 33 kërkesa.
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - ka patur gjithsej 356 kërkesa, të shqyrtuara 298 kërkesa.

Drejtoria për Bujqësi dhe Shërbime Veterinare - ka patur gjithsej 30 kërkesa, të shqyrtuara 15 kërkesa.
Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport - ka patur 83 kërkesa, të shqyrtuara 60 kërkesa.
Drejtoria për siguri dhe emergjencë ka patur gjithsej 26 kërkesa të miratuar 14 kërkesa 2 të refuzuara ndërsa 10 kërkesa nuk janë shqyrtuar ende.
Drejtoria e Inspekcionit - ka patur gjithsej 498 kërkesa, të shqyrtuara 450 kërkesa.

Komuna e Kamenicës

Komuna e **Kamenicës** ka dërguar raportin për gjashtë (6) drejtori. Numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori është 7 304 kërkesa, të shqyrtuara 7 278 kërkesa ose 99.64%. Prej tyre:

Drejtoria për Administratë dhe Personel - janë pranuar 5 862 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Financa Ekonomi dhe Zhvillim - janë pranuar 849 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Planifikim Urban, Kadaster dhe Mbrojtje të Mjedisit - janë pranuar 145 kërkesa, të shqyrtuara 119 kërkesa.
Drejtoria për arsim dhe Kulturë - ka patur gjithsej 67 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - janë pranuar 358 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë - ka patur gjithsej 23 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.

Komuna e Novobërdës

Komuna e **Novobërdës** ka dërguar raportin për pesë (5) drejtori. Numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori, është 303 kërkesa, të shqyrtuara kemi 299 ose 99%. Prej tyre:

Drejtoria për Administratë dhe Personel - janë pranuar gjithsej 185 kërkesa, prej tyre 183 të shqyrtuara.
Drejtoria për Financa Ekonomi dhe Zhvillim - janë pranuar 3 kërkesa, prej të cilave 2 të shqyrtuara.
Drejtoria për Planifikim Urban, Kadaster dhe Mbrojtje të Mjedisit - janë pranuar 274 kërkesa dhe që të gjitha të shqyrtuara.

Drejtoria për Arsim dhe Kulturë - janë pranuar 13 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - janë pranuar 24 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.

Komuna e Vitisë

Komuna e **Vitisë** ka dërguar raportin për tetë (8) drejtori. Numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori, është 2 348 kërkesa, të shqyrtuara 2 144 kërkesa ose 91.31%. Prej tyre:

Drejtoria për Administratë dhe Personel - janë pranuar gjithsej 580, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Financa Ekonomi dhe Zhvillim - janë pranuar gjithsej 320 kërkesa, të shqyrtuara 294 kërkesa.
Drejtoria për Planifikim, Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit - janë pranuar gjithsej 129 kërkesa, të gjitha janë shqyrtuar.
Drejtoria për Arsim dhe Kulturë - janë pranuar 120 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale- janë pranuar gjithsej 430 kërkesa, të shqyrtuara janë 253 kërkesa.
Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë - janë pranuar 398 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Bujqësi - janë pranuar 47 kërkesa, prej tyre 46 kërkesa të shqyrtuara.
Drejtoria për Inspekcion - janë pranuar 324 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.

Komuna e Ferizajit

Komuna e **Ferizajit** ka dërguar raportin për dhjetë (10) drejtori. Numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori është 16 827 kërkesa, të shqyrtuara 15 557 kërkesa ose 92.45%. Prej tyre:

Drejtoria për Administratë dhe Personel - janë pranuar gjithsej 4 334 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Urbanizëm, Gjeodezi, Pronë dhe Kadastër, dhe Mbrojtje të Mjedisit - janë pranuar 7 145 kërkesa, të shqyrtuara gjithsej 7 115 kërkesa.
Drejtoria për Arsim - janë pranuar 1 104 kërkesa, të shqyrtuara 941 kërkesa.

Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Buxhet - janë pranuar 716 kërkesa. Prej tyre 688 kërkesa të shqyrtuara.
Drejtoria për Planifikim dhe Zhvillim - ka patur gjithsej 109 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - janë pranuar 1 246 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural – ka patur gjithsej 67 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport - ka patur gjithsej 130 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë - ka patur gjithsej 64 kërkesa, të shqyrtuara 56 kërkesa.
Drejtori e Inspekcionit - ka patur gjithsej 807 kërkesa, të shqyrtuara 770 kërkesa.

Komuna e Hanit të Elezit

Komuna e **Hanit të Elezit** ka dërguar raportin për gjashtë (6) drejtori. Numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori është 246, të shqyrtuara 246 kërkesa ose 100%. Prej tyre:

Drejtoria për Administratë dhe Personel - janë pranuar gjithsej 75 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Financa Ekonomi dhe Zhvillim - janë pranuar gjithsej 85 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Planifikim Urban, Kadaster dhe Mbrojtje të Mjedisit - janë pranuar gjithsej 50 kërkesa, që të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Arsim dhe Kulturë - janë të pranuara 18 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - janë të pranuara 16 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Rini dhe Sport - ka patur gjithsej 2 kërkesa, të dyja të shqyrtuara.

Komuna e Shtërpcës

Komuna e Shtërpcës ka dërguar raportin për pesë (5) drejtori. Numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori është 2 552, të shqyrtuara kemi 2 551 kërkesa ose 99.96%. Prej tyre:

Drejtoria për Administratë dhe Personel - janë pranuar gjithsej 1 166 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.

Drejtoria për Ekonomi, Financa, Bujqësi dhe Pylltari - janë pranuar gjithsej 398 kërkesa, të shqyrtuara 398 kërkesa.
Drejtoria për Planifikim, Rindërtim, Zhvillim, Urbanizëm dhe Shërbime Publike - janë pranuar gjithsej 15 kërkesa, të shqyrtuara 14 kërkesa.
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - janë të pranuara 7 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë - ka patur gjithsej 966 kërkesa, të gjitha janë të shqyrtuara.

Komuna e Mitrovicës

Komuna e Mitrovicës ka dërguar raportin për tetë (8). Numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori është 3892 kërkesa, të shqyrtuara 1853 kërkesa ose 47.61%. Prej tyre:

Drejtori e Administratës dhe Personelit - janë pranuar 348 kërkesa, të shqyrtuara 255 kërkesa.
Drejtoria për Arsim dhe Kulturë,Rini dhe Sport - janë pranuar 135 kërkesa, të shqyrtuara 119 kërkesa.
Drejtoria për Financa Ekonomi dhe Zhvillim – janë pranuar 831 kërkesa, të shqyrtuara 181 kërkesa.
Drejtoria për Planifikim Urban Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit - janë pranuar 1301 kërkesa, të shqyrtuara 417 kërkesa.
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - ka patur gjithsej 505 kërkesa, të shqyrtuara 338 kërkesa.
Drejtoria për Bujqësi dhe Inspektorat - ka patur gjithsej 555 kërkesa, të shqyrtuara gjithsej 473 kërkesa
Drejtoria për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë - ka patur gjithsej 209 kërkesa, të shqyrtuara 62 kërkesa.
Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim - ka patur gjithsej 8 kërkesa, të shqyrtuara 8 kërkesa.

Komuna e Vushtrrisë

Komuna e Vushtrrisë ka dërguar raportin për nëntë (9) drejtori. Numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori është 5 610 kërkesa, të shqyrtuara kemi 5 471 kërkesa ose 97.52%. Prej tyre:

Drejtoria për Administratë dhe Personel - janë pranuar 1 273 kërkesa, të shqyrtuara të gjitha.

Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim - ka patur gjithsej 176 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara
Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit - ka patur gjithsej 1 428 kërkesa, të shqyrtuara 1382 kërkesa**.**
Drejtori për Arsim - ka patur gjithsej 839 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - ka patur gjithsej 1 233, kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport - ka patur gjithsej 1 kërkesë, që nuk është shqyrtuar.
Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi dhe Inspektorat - ka patur gjithsej 567 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Emergjencë dhe Shërbime Publike - janë pranuar 92 kërkesa, nuk ka shënime nëse janë shqyrtuar.
Drejtoria për Prokurim Publik - janë pranuar 1 kërkesë, e shqyrtuar.

Komuna e Skenderajt

Komuna e **Skenderajt** ka dërguar raportin për tetë (8) drejtori. Numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori është 5338 kërkesa, të shqyrtuara 4773 ose 89.38%. Prej tyre:

Drejtoria për Administratë dhe Personel - janë pranuar gjithsej 543 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit - ka patur gjithsej 543 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport - janë pranuar 67 kërkesa, të shqyrtuara 61 kërkesa.
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - janë pranuar gjithsej 2913 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Bujqësi, Financa, Inspektoriat dhe Zhvillim - janë pranuar 365 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Emergjencë dhe Shërbime Publike - ka patur gjithsej 88 kërkesa, të shqyrtuara të gjitha.
Drejtoria për Inspekcion ka patur 339 kërkesa 321 janë miratuar 18 janë të pezulluara .
Drejtorai për Gjeodezi Kadstër dhe Pronësi ka patur 481 kërkesa 447 të miratuara 34 të refuzuara.

Komuna e Prizrenit

Komuna e **Prizrenit** ka dërguar raportin për njëmbëdhjetë (11) drejtori. Numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori është 8 924 kërkesa, të shqyrtuara 8 144 kërkesa ose 91%. Prej tyre:

Drejtoria për Administratë - janë pranuar 1 458 kërkesa, të shqyrtuara 1 401 kërkesa.
Drejtoria për Pronë - ka patur gjithsej 166 kërkesa, të shqyrtuara gjithsej 156 prej tyre.
Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim – janë pranuar gjithsej 701 kërkesa, të shqyrtuara të gjitha.
Drejtoria për Planifikim Urban - ka patur gjithsej 1 256 kërkesa, të shqyrtuara 1091 kërkesa.
Drejtoria për Kadastër – janë pranuar gjithsej 2 697 kërkesa, të shqyrtuara 2 520 kërkesa.
Drejtoria për Arsim - ka patur gjithsej 285, të shqyrtuara 272 kërkesa.
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale – janë pranuar 542 kërkesa, të shqyrtuara 541 kërkesa.
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport – ka patur gjithsej 182 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Bujqësi – janë pranuar gjithsej 75 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Inspekcion – janë pranuar gjithsej 455 kërkesa, të shqyrtuara janë 447 kërkesa.
Drejtoria për Emergjencë dhe Shërbime Publike - ka patur gjithsej 1 061 kërkesa, të shqyrtuara 712 kërkesa.

Komuna e Dragashit

Komuna e Dragashit raportin ka dërguar për nëntë (9) drejtori. Numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori është 3 980 kërkesa, të shqyrtuara kemi 3452 kërkesa ose 86.73%. Prej tyre:

Drejtoria e Administratës dhe e Personelit - ka patur gjithsej 1 808 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim - ka patur gjithsej 254 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit - ka patur gjithsej 347 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Arsim - ka patur gjithsej 916 kërkesa, të shqyrtuara 911 kërkesa.

Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport - ka patur gjithsej 20 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale - ka patur gjithsej 67 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Ekonomi dhe Bujqësi - ka patur gjithsej 46 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Inspektorat - ka patur gjithsej 518 kërkesa dhe të tgjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Emergjencë dhe Shërbime Publike - ka patur gjithsej 4 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.

Komuna e Malishevës

Komuna e **Malishevës** ka dërguar raportin për tetë (8) drejtori. Numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori është 4 881 kërkesa, të shqyrtuara 4 498 kërkesa ose 92.15%. Prej tyre:

Drejtoria për Administratë dhe Personel - janë pranuar gjithsej 3710 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim – janë pranuar gjithsej 155 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit - janë pranuar 472 kërkesa, të shqyrtuara 91 kërkesa.
Drejtoria për Arsim dhe Kulturë – janë pranuar gjithsej 26 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Shëndetësi dhe mirëqenie sociale ka patur gjithsej 304 kërkesa 304 janë miratuar.
Drejtoria për Rini dhe Sport - janë pranuar 23 kërkesa, të shqyrtuara 21 kërkesa.
Drejtoria për Ekonomi Bujqësi dhe Inspektorat – janë pranuar 172 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Emergjencë dhe Shërbime Publike – janë pranuar gjithsej 19 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.

Komuna e Suharekës

Komuna e **Suharekës** ka dërguar raportin për nëntë (9) drejtori. Numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori është 6 996 kërkesa, të shqyrtuara 6 903 kërkesa ose 98.67%. Prej tyre:

Drejtoria për Administratë dhe Personel – janë pranuar 986 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim - janë pranuar 1 368 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit – janë pranuar gjithsej 1507 kërkesa, të shqyrtuara 1487 kërkesa.
Drejtoria për Arsim - janë pranuar gjithsej 646 kërkesa, të shqyrtuara 643 kërkesa.
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - janë pranuar gjithsej 1 517 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport - ka patur gjithsej 68 kërkesa, të shqyrtuara 61 kërkesa.
Drejtoria për Inspektorat - janë pranuar 233 kërkesa, të shqyrtuara 231 kërkesa.
Drejtoria për Bujqësi, Pylltari, Blegtori dhe Zhvillim Rural - ka patur gjithsej 218 kërkesa, që të gjitha janë të shqyrtuara.
Drejtoria për Emergjencë dhe Shërbime Publike – ka patur gjithsej 453, të gjitha të shqyrtuara.

Komuna e Rahovecit

Komuna e Rahovecit ka dërguar raportin për tetë (8) drejtori. Numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori është 14 561 kërkesa, të shqyrtuara 14 305 kërkesa ose 98.24%. Prej tyre:

Drejtoria për Administratë dhe Personel - janë pranuar gjithsej 8 328 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara
Drejtoria për Buxhet dhe Financa - ka patur gjithsej 942 kërkesa, të shqyrtuara të gjitha.
Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit - janë pranuar gjithsej 3 535 kërkesa, të shqyrtuara 3 282 kërkesa.
Drejtoria për Arsim - janë pranuar 93 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - janë pranuar 804 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport - ka patur gjithsej 41 kërkesa, të shqyrtuara 37 kërkesa.
Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural – ka patur gjithsej 122 kërkesa, prej tyre 116 të shqyrtuara.
Drejtoria për Ekonomi - ka patur gjithsej 342 kërkesa, të shqyrtuara të gjitha.

Komuna e Mamushës

Ka dërguar raportin për tre (3) drejtori. Numri i përgjithshëm i kërkesave është 768 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara ose 100%. Prej tyre:

Drejtoria për Administratë dhe Personel - ka pranuar gjithsej 241 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim - ka patur gjithsej 492 kërkesa, që të gjitha janë shqyrtuar.
Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit - ka patur gjithsej 35 kërkesa dhe të gjitha janë shqyrtuar.

Komuna e Pejës

Komuna e Pejës ka dërguar raportin për tetë (8) drejtori. Numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori është 7 863 kërkesa, të shqyrtuara 7742 kërkesa ose 98.47%. Prej tyre:

Drejtoria për Administratë dhe Personel - janë pranuar gjithsej 3 223 kërkesa, të shqyrtuara 3218 kërkesa.
Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim - janë pranuar gjithsej 724 kërkesa, të shqyrtuara 629 kërkesa.
Drejtoria për Planifikim, Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit - janë pranuar gjithsej 1 273 kërkesa, të shqyrtuara 1 258 kërkesa.
Drejtoria për Arsim dhe Kulturë - janë pranuar 908 kërkesa, të gjitha janë shqyrtuar.
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - janë pranuar gjithsej 283 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim - janë pranuar gjithsej 332 kërkesa, të shqyrtuara 327 kërkesa.
Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi - ka patur gjithsej 18 kërkesa, të gjitha janë të shqyrtuara.
Drejtoria për Inspekcion - ka patur gjithsej 1073 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.

Komuna e Gjakovës

Komuna e **Gjakovës** ka dërguar raportin për dymbëdhjetë (12) drejtori. Numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori është 7114 kërkesa, të shqyrtuara 5702 kërkesa ose 80.15% . Prej tyre:

Drejtoria e Administratës së Përgjithshme - janë pranuar gjithsej 1440 kërkesa, janë miratuar 1253 të hedhura poshtë ,10 të pezulluara ndërsa në proces janë 175.
Drejtoria për Agrokulturë dhe Bujqësi - janë pranuar gjithsej 66 kërkesa, 6 kërkesa janë miratuar 60 kërkesa janë në proces.
Drejtoria për Arsim dhe shkencë - janë pranuar 1422 kërkesa, janë miratuar 684 kërkesa ,668 janë refuzuar ndërsa në proces janë 70 kërkesa.
Drejtoria për Buxhet dhe Financa - ka patur gjithsej 655 kërkesa janë miratuar 309 kërkesa, 136 janë refuzuar, në proces janë 210 kërkesa.
Drejtoria për Inspektorat - ka patur gjithsej 960 kërkesa, 725 janë miratuar ,1 është pezulluar në proces janë 234 kërkesa.
Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport - ka patur gjithsej 151 kërkesa, 30 kërkesa janë miratuar, 38 kërkesa janë refuzuar, në proces janë 83.
Drejtoria për Mbrojtje Civile dhe Gatishmëri Emergjente ka patur gjithsej 268 kërkesa , 210 janë miratuar, 1 është hedhur poshtë , 8 kërkesa janë refuzuar ndërsa 49 janë në proces.
Drejtoria për Punë Pasurore Juridike ka patur gjithsej 229 kërkesa, janë miratuar 34 kërkesa, 28 janë hedhur poshtë 3 kërkesa janë pezulluar, 4 janë refuzuar ndërsa 160 janë në proces.
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale ka patur gjithsej 361 kërkesa,112 janë miratuar, 2 kërkesa janë refuzuar 247 janë në proces.
Drejtoria për Shërbime Publike ka **patur gjithsej 216 kërkesa ,** 81 janë miratuar,4 janë hedhur poshtë, 21 janë pezulluar, 22 kërkesa janë refuzuar ndërsa 88 janë në proces.
Drejtoria për Urbanizëm ka patur gjithsej 747 kërkesa, 302 janë miratuar, janë hedhur poshtë 23 kërkesa, 114 janë pezulluar, janë refuzuar 48 kërkesa, 260 janë në proces.
Drejtoria për Zhvillim Ekonomik ka patur gjithsej 599 kërkesa, 574 janë miratuar, 5 janë refuzuar, në proces janë 20 kërkesa.

Komuna e Deçanit

Komuna e Deçanit ka dërguar raportin për tetë (8) drejtori. Numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori është 2 050 kërkesa, të shqyrtuara 2 026 kërkesa, ose 98.83% . Prej tyre:

Drejtoria për Administratë dhe Personel - ka patur gjithsej 890 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim - ka patur gjithsej 145 kërkesa, të shqyrtuara 136 kërkesa.
Drejtoria për Planifikim Urban, Kadaster dhe Mbrojtje të Mjedisit - ka patur gjithsej 784 kërkesa, të shqyrtuara 772 kërkesa.

Drejtoria për Arsim dhe Kulturë - ka patur gjithsej 2 kërkesa, të shqyrtuara të dyja.
Drejtoria për Rini dhe Sport - ka patur gjithsej 3 kërkesa, të shqyrtuara të gjitha.
Drejtoria për Ekonomi dhe Bujqësi - ka patur gjithsej 4 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Emergjencë dhe Shërbime Publike - ka patur gjithsej 94 kërkesa, të shqyrtuara 91 prej tyre.
Drejtoria për Inspekcion - ka patur gjithsej 128 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.

Komuna e Istogut

Komuna e **Istogut** ka dërguar raportin për tetë (8) drejtori. Numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori është 10 657 kërkesa, të shqyrtuara 10 439 kërkesa, ose 97.95%. Prej tyre:

Drejtoria për Administratë dhe Personel - janë pranuar gjithsej 6 274 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Financa Ekonomi dhe Zhvillim - janë pranuar gjithsej 2 299 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit - janë pranuar 1368 kërkesa, të shqyrtuara 1 188 kërkesa.
Drejtoria për Arsim dhe Kulturë - janë pranuar 17 kërkesa, prej të cilave vetëm 2 janë të shqyrtuara.
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - janë pranuar gjithsej 157 kërkesa, të shqyrtuara të gjitha.
Drejtoria për Inspektorat - janë pranuar gjithsej 128 kërkesa, 119 kërkesa të shqyrtuara.
Drejtoria për Bujqësi - janë pranuar gjithsej 60 kërkesa, të shqyrtuara 54 kërkesa.
Drejtoria për Emergjencë dhe Shërbime Publike - janë pranuar gjithsej 354 kërkesa, të shqyrtuara 346.

Komuna e Klinës

Komuna e **Klinës** ka dërguar raportin për shtatë (7) drejtori. Numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori është 20 625 kërkesa, të shqyrtuara 19 805 kërkesa ose 96.02%. Prej tyre:

Drejtoria për Administratë dhe Personel - janë pranuar gjithsej 2 310, të gjitha të shqyrtuara.

Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim - janë pranuar gjithsej 16 869, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit - janë pranuar 625 kërkesa, të shqyrtuara 49 kërkesa.
Drejtoria për Arsim dhe Kulturë - janë pranuar 233 kërkesa, të shqyrtuara të gjitha.
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - janë pranuar gjithsej 195 kërkesa, të shqyrtuara 190 kërkesa.
Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Inspektorat - janë pranuar gjithsej 61 kërkesa, të shqyrtuara të gjitha.
Drejtoria për Emergjencë dhe Shërbime Publike - janë pranuar gjithsej 332 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara**.**

Komuna e Junikut

Komuna e Junikut ka dërguar raportin për pesë (5) drejtori. Numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori është 299 kërkesa, të shqyrtuara 274 kërkesa ose 91.63 %. Prej tyre:

Drejtoria për Administratë dhe Personel - janë pranuar gjithsej 136 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Ekonomi, Buxhet dhe Financa - janë pranuar gjithsej 35 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
Drejtoria për Planifikim, Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis - janë pranuar gjithsej 40 kërkesa, të shqyrtuara 38 kërkesa.
Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport - janë pranuar gjithsej 78 kërkesa, të shqyrtuara 55 kërkesa.
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - janë pranuar gjithsej 10 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.

Komuna e Kaçanikut

Komuna e Kaçanikut ka dërguar raportin për shtatë (7) drejtori .Numri i përgjitshëm i kërkesave në këto drejtori është 6948 kërkesa, 6755 kërkesa janë të shqyrtuara ose 97% . Prej tyre:

Drejtoria për Administratë dhe Personel ka pranuar gjithsej 329 kërkesa prej tyre janë shqyrtuar 294 kërkesa.

Drejtoria për Financa Ekonomi dhe Zhvillim ka pranuar gjithsej 1.855 kërkesa prej tyre ka shqyrtuar 1.769.
Drejtoria për Planifikim, Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit ka pranuar 4391 prej tyre ka shqyrtuar 4362.
Drejtoria për Arsim, Kulturë dhe Sport ka pranuar 21 kërkesa prej tyre ka shqyrtuar 21.
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale ka pranuar 256 kërkesa të gjitha i ka shqyrtuar.
Drejtoria për Ekonomi Bujqësi dhe Inspektorat ka pranuar 48 kërkesa prej tyre ka shqyrtuar 43 kërkesa.
Drejtoria për Emergjencë dhe Shërbime Publike ka pranuar gjithsej 60 kërkesa prej tyre janë shqyrtuar 52 kërkesa.

Numri i lëndëve të pranuara dhe të shqyrtura gjatë vitit 2008 është paraqitur në tabelën si vijon:

Numri i lëndëve të pranuara dhe të shqyrtuara në Komuna gjatë vitit 2008		
	Numri i lëndëve të pranuara	Numri i lëndëve të shqyrtuara
Komuna		
Deçan	2050	2026
Dragash	3980	3452
Ferizaj	16827	15557
Fushë Kosovë	3298	2344
Gjakovë	7114	5702
Gjilan	8046	7020
Gllogoc	8961	8569
Hani i Elezit	246	246
Istog	10657	10439
Junik	299	274
Kaçanik	6948	6724
Kamenicë	7304	7278
Klinë	20625	19805
Leposaviç		
Lypjan	8702	8563
Malishevë	4881	4498
Mamushë	768	768
Mitrovicë	3892	1853
Novobërdë	499	464
Obiliq	1791	1496

Pejë	7863	7742
Prishtinë	20137	17644
Podujevë	10488	10416
Prizren	8924	8144
Rahovec	14561	14305
Shtime	979	979
Skënderaj	5338	4773
Shtërpcë	2552	2551
Suharekë	6996	6903
Viti	2348	2144
Vushtrri	5610	5471
Zubin Potok		
Zveçan		
Gjithsej	193217	188150

Konkluzione të përgjithshme në lidhje me evidentimin e gjendjes aktuale në Komunat e Republikës së Kosovës për trajtimin e kërkesave në shkallë të parë të procedurës administrative.

- *Të dhënat e paraqitura në raport në lidhje me efikasitetin dhe azhuritetin në komuna kryesisht rezultojnë të pasakta;*
- *Në shumicën e komunave të dhënat në zyrën pritëse nuk azhurnohen me kohë;*
- *Sistemi digjital (Intraneti) është i instaluar në zyrën pritëse në Komunë, por të dhënat nuk freskohen dhe ka vështirësi në kthimin e dokumentacionit në këtë zyrë;*
- *Në librat e protokollit të shkurtër (intern) evidentohen pranimet e kërkesave, ndërsa pas shqyrtimit të kërkesës libri i protokollit nuk udhëhiqet fare, për kërkesat dhe parashtresat e qytetarëve mbahen libra intern nëpër drejtori;*
- *Pavarësisht se përfaqësuesit e komunave kanë nënshkruar deklaratën e saktësisë së të dhënave, gjatë plotësimit të pyetësorëve në takimet e përbashkëta me ekipet e monitorimit të MAPL-së, kur gjendja është evidentuar në terren, të dhënat kryesisht kanë rezultuar të pasakta.*

PJESA E TRETË
PROMOVIMI I TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE FUNKSIONALIZIMI I NJËSIVE PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË KOMUNA

Promovimi dhe Respektimi i të drejtave të njeriut në nivelin lokal

Sfondi Ligjor - Sipas përgjegjësive ligjore që ka, MAPL siguron që aktivitetet dhe funksionimi i komunave të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe në respektim të të drejtave të njeriut në nivelin lokal të qeverisjes. Në lidhje me këtë, MAPL ka nxjerrë udhëzimin administrativ për themelimin e Njësive për të Drejtat e Njeriut (Udhëzimi Administrativ – MAPL – nr. 2008/02 "Për ndryshimin e udhëzimit 2007/08 "Për themelimin e njësive për të drejtat e njeriut në komuna"). Me këtë udhëzim administrativ themelohen njësitë funksionale për të drejtat e njeriut në komuna (NJDNJK), si mekanizëm i qëndrueshëm dhe përgjegjës për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në nivelin komunal, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe politikat e institucioneve të Kosovës. Përveç kësaj edhe Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, neni 17 (i), obligon komunat në respektimin e të drejtave të njeiut në nivelin lokal të qeverisjes.

Themelimi i njësive për të drejtat e njeriut në nivelin Lokal

Vlerësimi i gjendjes aktuale - Në 26 komuna janë themeluar njësitë për të drejtat e njeriut dhe të gjitha komunat kryesisht janë kompletuar me numrin e caktuar përgjegjës të stafit .
Sipas nenit 8.3. të Udhëzimit Administrativ, Komunat obligohen të sigurojnë zyra të veçanta për këtë kategori punonjësish. Në lidhje me këtë, 22 Komuna kanë siguruar zyra, ndërsa në 4 komuna kjo pjesë e stafti ka mbetur pjesë e drejtorive të tjera, për asye se në të njejtën kohë janë zyrtarë në departamentin e arsimit apo në zyren lokale të komuniteteve.
NJDNJK-ja, bazuar në nenin 6.1 të U.A. nr.2008/02, ka tre anëtarë, koordinatorin, zyrtarin për barazi gjinore, për komunitete dhe zyrtarin për të drejta të fëmijëve. Për shkak të pamundësisë së rekrutimit të stafit dhe buxhetit të kufizuar, komunat i kanë themeluar njësitë nga stafi ekzistues, konform nenit 6.2 të U.A. 2008/02.

Koordinatori i Njësisë për të Drejtat e Njeriut

Në 19 komuna koordinator i njësisë është emëruar zyrtari për barazi gjinore, i cili mbulon edhe fushën e mundësive të barabarta (kjo është bërë sipas propozimeve të MAPL-së, duke pasur parasysh së kjo kategori e zyrtarëve komunalë ka përvojë në fushën e të drejtave të njeriut. Njëkohësisht, është marrë në konsideratë edhe investimi në kohëzgjatje prej pesë vitesh në lidhje me ndërtimin e kapaciteteve të tyre.) Në disa Komuna, koordinatori njëkohësisht mbulon edhe

një resor të caktuar nga fusha e kompetencave të Komunave. Në tri komuna, Mitrovicë, Skenderaj dhe Dragash, koordinatori i njësisë mbulon edhe fushën e të drejtave të fëmijëve, ndërsa në komunën e Rahovecit, koordinatori i njësisë në të njejtën kohë është edhe zyrtar për integrime evropiane. Në Obiliq Koordinatori i njësisë është njëkohësisht edhe zyrtar i informimit.
Koordinatorët e 19 komunave janë të pajisur me kontratë pune sipas Ligjit mbi shërbimin civil, ndërsa 7 koordinatorë kanë kontratë konform U.A. 2008/02.

Zyrtari për komunitete

Në 25 komuna janë përcaktuar zyrtarët për komunitete (përveç Gllogocit), dhe janë të pajisur me kontrata pune konform ligjit mbi shërbimin civil. Zyrtarët kryesisht punojnë në zyrat lokale të komuniteteve.

Zyrtari për të drejtat e fëmijëve

Pozitën e zyrtarit për të drejtat e fëmijëve në komunë, në të shumtën e rasteve e mban zyrtari nga drejtoria e arsimit, rinisë dhe kulturës.
Në 23 komuna janë ricaktuar zyrtarët për të drejta të fëmijëve. Probleme janë paraqitur në komunën e Novobërdës, për arsye se zyrtari i zgjedhur i përket minoritet serb dhe duke pasur parasysh faktet e njohura të vështirësive të funksionimit në këtë komunë, ky zyrtar vazhdimisht ka munguar në punë. Të gjithë zyrtarët për të drejta të fëmijëve në komunat e tjera janë pajisur me kontrata pune sipas ligjit mbi shërbimin civil.

Organizimi i punës dhe funksionalizimi NJDNJK-vë

NJDNJK-të funksionojnë si ekip dhe kryejnë punët e detyrat, si është përcaktuar me legjislacionin në fuqi. Njësitë për të drejtat e njeriut në nivelin lokal në vazhdimësi kanë avancuar respektimin e të drejtave të njeriut dhe kanë paraqitur shqetësimet e tyre në rastet kur evidentohen shkelje. Një rol të rëndësishëm në funksionalizimin e NJDNJK-ve kanë pasur edhe trajnimet e organizuara nga MAPL. Për gjashtë muaj zyrtarët e këtyre njësive kanë pasur rastin të njihen me çështje të ndryshme dhe të përcjellin leksione nga profesorë dhe trajnerë me eksperiencë nga fusha e të drejtave të njeriut.

NJDNJK-të veprojnë si mekanizëm funksional për monitorimin e respektimit të drejtave të njeriut në komuna.

Përfshirja e NJDNJK-së në strukturën organizative të komunës

Shumica e Njësive për të drejtat e njeriut janë të përfshira në kuadër të strukturës organizative të drejtorisë së administratës, mirëpo ka edhe njësi që i përgjigjen kryetarit.

Komunat si vijon: Prizreni, Malisheva, Vushtrria, Podujeva, Ferizaj dhe Suhareka kanë siguruar mjete të mjaftueshme për zhvillimin e aktiviteteve të NJDNJK-së konform nenit 8.2., ndërsa 19 komuna nuk kanë specifikuar mjetet buxhetore në lidhje me aktivitetet e këtyre njësive për vitin 2009.

Bashkëpunimi dhe koordinimi i aktiviteteve të NJDNJK-së me strukturat komunale, ndërkombëtare dhe OJQ-të

NJDNJK bashkëpunon dhe koordinon aktivitetet me strukturat e tjera komunale, ndërkombëtare dhe OJQ-të, për zhvillimin e aktiviteteve me qëllim të promovimit, sensibilizimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Një bashkëpunim dhe koordinim të tillë me strukturat e cekura më lartë e kanë bërë 19 komuna, përmes aktiviteteve si: organizim i tryezave, takimeve dhe publikimin e broshurave. Përkundër faktit se NJDNJK-të kanë qenë në fazën e konsolidimit dhe të ndërtimit të kapaciteteve profesionale gjatë vitit 2008, Njësitë kanë ndërmarrë aktivitete të ndryshme nga të gjitha fushat e të drejtave të njeriut me qëllim të ngritjes së vetëdijes së zyrtarëve të administratës komunale dhe qytetarëve mbi të drejtat e njeriut. Janë realizuar një numër i madh projektesh, takime, trajnime për senzibilizimin e të drejtave të njeriut në sferat: e barazisë gjinore, mundësive të barabarta, të drejtat e fëmijëve, të drejtat e minoriteteve dhe personave me aftësi të kufizuar. Përjashtim nga aktiviteti i ngjeshur i njësiteve, sipas të dhënave që MAPL ka në dispozicion, bëjnë komunat e Dragashit dhe Novobërdës.
Aktivitetet e komunave janë bashkëfinancuar nga komuna dhe organizata të tjera ndërkombëtare, vendore dhe OJQ-të, të tilla si OSBE, UNHCR, UNDP, FDI, KFOR, UNMIK, etj...
Përfitues të këtyre projekteve kanë qenë zyrtarët komunalë, gratë, fëmijët, personat me aftësi të kufizuar dhe minoritetet.

Mundësitë e barabarta

Konform nenit 3 të U.A. 2008/02, një ndër përgjegjësitë e NJDNJK- është edhe monitorimi i mundësive të barabarta. Sipas të dhënave që MAPL ka në

dispozicion, në shumicën e rasteve të rekrutimit të stafit, anëtarët e NJDNJK janë anëtarë të panelit apo vëzhgojnë rekrutimin me qëllim eliminimin e shkeljeve të mundshme. Vetëm në komunën e Kamenicës dhe Istogut kjo kategori e zyrtarëve akoma nuk kanë pasur rastin të jenë në panele intervistuese, as si anëtarë, as si vëzhgues.

Koordinatorët e 9 komunave marrin pjesë në hartimin e rregulloreve, strategjive, politikave komunale, shpesh marrin pjesë edhe anëtarët e tjerë të NJDNJK-së, varësisht prej dokumentit që hartohet. Por ka edhe Njësi që nuk marrin pjesë në këto aktivitete. Shumica e anëtarëve të NJDNJK-ve përcjellin mbledhjet e kuvendit, takimet e stafit të lartë, ofrojnë këshilla për zyrën ligjore dhe drejtoritë e tjera, sa herë që kjo kërkohet. NJDNJK nuk është pjesëmarrëse në takimet me stafin e lartë udhëheqës të këtyre komunave: Kamenicë, Lipjan, Skenderaj, Gjilan, Viti, Ferizaj dhe Vushtrri.

Përfshirja e minoriteteve në komuna

Në të gjitha komunat ka pjesëtarë të komuniteteve të ndryshme, të përfaqësuar si pjesë e stafit politik, ashtu edhe në strukturat e tjera komunale. Njësia për të drejtat e njeriut në komuna është një strukturë heterogjene dhe multietnike. Në përbërjen e saj ka edhe zyrtarë shqiptarë, serbë, turq, romë dhe boshnjakë, të cilët kanë qenë shumë bashkëpunues, kanë marrë pjesë në të gjitha trajnimet, si dhe kanë treguar gadishmëri për bashkëpunim dhe integrim edhe të minoriteteve të tjera në institucionet e Kosovës.

Me qëllim integrimin e minoriteteve, komunat rregullisht sigurojnë transportin për nevojat e minoriteteve.

Sipas të dhënave që MAPL ka në dispozicion në lidhje me numrin e të kthyerve nga vendet e treta, komunat kanë këtë numër të të kthyerve si vijon: Prizreni 23 persona; Shtimja 1 familje nga Maqedonia; Kamenicë 10 familje serbe; Deçani 3 persona; Peja 65 persona; Lipjani 19 persona; Istogu 20 persona; Skenderaj 1 person; Prishtina - dorëzuar kërkesat për kthimin e 17 familjeve serbe, rome e boshnjake; Dragashi 122 familje; Ferizaj 166 veta (romë e ashkali); Vitia 4 persona (serb); Gjakova 404 persona të kthyer; Klina 69 persona; Vushtrria 3 persona (ashkali).
Ndërsa për komunat Novobërdë, Obiliq, Gllogoc, Kaçanik, Mitrovicë, Malishevë, Gjilan, Podujevë, Rahovec dhe Suharekë nuk kanë mundur të sigurohen të dhëna në lidhje me numrin e të kthyerve.

Përdorimi i gjuhëve

Të gjitha dokumentet që nxjerr komuna përkthehen në gjuhët zyrtare, sipas Ligjit mbi Përdorimin e Gjuhëve, mirëpo disa prej tyre, në varësi të kërkesave të qytetarëve, përkthehen edhe në gjuhën e kërkuar, gjegjësisht në gjuhën në përdorim zyrtar.
Shumica e komunave nuk kanë nxjerrë ende rregulloren për përdorimin e gjuhëve, disa janë në proces të draftimit. Shërbimet komunale ofrohen në gjuhën e palës sa herë që të jetë e mundur.

Raportimi

Koordinatori i NJDNJK-së, konform nenit 4 të U.A. 2008/02, raporton në baza mujore, tre dhe gjashtë mujore dhe sa herë që kërkohet, tek drejtori i administratës apo tek kryesuesi i kuvendit, si dhe tek udhëheqësi i divizionit për të drejta të njeriut në MAPL.
Të gjitha komunat, gjegjësisht koordinatorët e NJDNJK-ve, kanë dërguar raportin e punës. Me përjashtim të komunës së Deçanit, Novobërdës dhe Obiliqit, të gjitha komunat e tjera kanë hartuar dhe dorëzuar planin e punës për vitin 2009 në DDNJ të MAPL-së.

Ngritja e kapaciteteve

MAPL, në bashkëpunim dhe përkrahje e OSBE, ka hartuar "Programin përkrahës për themelimin e NJDNJK-ve". Ky program është mbështetur dhe bashkëorganizuar me IKAP-in, dhe është financuar nga MAPL. Programi ka qenë i ndarë në katër faza.

Sipas agjendës, realizimi i këtij projekti ka paraparë 20 module të trajnimeve për zyrtarët komunal, përfshirë të gjitha fushat e të drejtrave të njeriut. Nga 20 module, 5 prej tyre janë mbajtur në periudhën qershor deri në gjysmën e korrikut. Modulet e tjera (15) janë realizuar nga shtatori deri në fund të vitit 2008.
Trajnimet i kanë ndjekur 76 zyrtarë komunal për të drejtat e njeriut të të dy gjinive dhe përkatësive të ndryshme duke përfshirë shqiptarë, serbë, boshnjakë, turqë, RAE, persona me aftësi të kufizuar, etj...

TABELA 1: PËRQINDJA E PERFAQËSIMIT TË FEMRAVE NË SHËRBIM CIVIL NË KOMUNA

Komuna		Administratë			Shendetesia			Arsimi			Nr. Total i Sherbyesve Civil			% e Femrave		
		2006	2007	2008	2006	2007	2008	2006	2007	2008	2006	2007	2008	2006	2007	2008
Gllogoc-	P	144	144	137	187	185	185	940	944	950	1271	1273	1272	26.67%	27.42%	29.95%
	M	115	105	108	64	71	112	753	738	671	932	914	891			
	F	29	29	29	123	114	73	187	206	279	339	349	381			
Viti	P	170	153	163	170	149	308	853	78	873	1193	380	1344	32.10%	39.21%	33.04%
	M	141	133	140	58	53	154	611	45	606	810	231	900			
	F	29	20	23	112	96	154	242	33	267	383	149	444			
Podujevë	P	202	253	238	258	248	246	1385	1386	1418	1845	1887	1902	67.21%	30.90%	32.75%
	M	149	202	191	95	90	91	361	1012	989	605	1304	1271			
	F	53	51	47	163	158	155	1024	374	421	1240	583	623			
Lipjan	P	32	30	155	61	61	261	157	157	1063	250	248	1479	58.80%	59.27%	37.32%
	M	26	24	132	10	10	105	67	67	699	103	101	936			
	F	6	6	32	51	51	156	90	90	364	147	147	552			
Deçan	P	113	129	108	150	147	124	684	653	460	947	929	692	34.95%	33.69%	37.86%
	M	82	99	81	47	49	40	487	468	309	616	616	430			
	F	31	30	27	103	98	84	197	185	151	331	313	262			
Gjilan	P	273	233	266	340	340	321	1907	1907	2005	2520	2480	2592	39.25%	39.15%	41.36%
	M	217	194	260	99	99	82	1216	1216	1223	1532	1509	1565			
	F	57	39	51	241	241	239	691	691	782	989	971	1072			
Gjakove	P	299	267	265	574	360	360	1670	1541	1570	2543	2168	2195	52.03%	49.45%	50.71%
	M	208	201	199	179	98	99	833	794	784	1220	1093	1082			

	F	91	66	66	395	262	261	837	744	786	1323	1072	1113			
Kline	P	152		135	141		138	645		653	938		926	29.74%		29.70%
	M	115		104	69		64	475		483	659		651			
	F	37		31	72		74	170		170	279		275			
Rahovec	P	134			131			836			1101			28.61%		
	M	118			62			606			786					
	F	16			69			230			315					
Peje	P	309	309	284	359	359	368	1597	1597	1605	2265	2265	2257	47.64%	47.64%	51.40%
	M	214	214	196	80	80	87	892	892	814	1186	1186	1097			
	F	95	95	88	279	279	281	705	705	791	1079	1079	1160			
Fushe Kosove	P	142	136	142	109	109	102	463	463	498	714	708	742	51.68%	51.55%	50.27%
	M	103	98	102	36	39	32	206	206	235	345	343	369			
	F	39	38	40	73	70	70	257	257	263	369	365	373			
Obiliq	P	110	93	91	102	109	105	432	412	416	644	614	612	45.03%	47.39%	49.02%
	M	66	54	54	39	40	31	249	228	227	354	322	312			
	F	44	38	37	63	69	74	183	184	189	290	291	300			
Prizren	P	330	285	295	493	474	477	2285	2262	2350	3108	3021	3122	55.60%	0.00%	39.43%
	M	262		231	225		216	831		1444	1318		1891			
	F	6		64	268		261	1454		906	1728		1231			
Malishevë	P	145	145	133	127	126	126	961	965	982	1233	1236	1241	21.41%	21.93%	22.56%
	M	118	118	113	66	62	62	785	785	768	969	965	943			
